



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2021 – Numri: 204

Tiranë – E enjte, 30 dhjetor 2021

PËRMBAJTJA

	Faqe
Ligj nr. 125/2021, datë 16.12.2021	Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Mbretërisë së Bashkuar të Britanisë së Madhe, dhe Irlandës së Veriut mbi transferimin e personave të dënuar..... 20541
Dekret i Presidentit nr. 13400, datë 24.12.2021	Për shpallje ligji..... 20553
Ligj nr. 129/2021, datë 20.12.2021	Për statusin “Fëmijë në përkujdesje të Republikës”..... 20553
Dekret i Presidentit nr. 13402, datë 24.12.2021	Për shpallje ligji..... 20557
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 814, datë 24.12.2021	Për kompensimin financiar të pronarëve të pasurive të paluajtshme që preken nga ndërtimet e legalizuara..... 20558
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 821, datë 24.12.2021	Për përcaktimin e standardeve bazë për ruajtjen e Aviacionit Civil nga aktet e ndërhyrjes së paligjshme, që rrezikojnë sigurinë e Aviacionit Civil..... 20590
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 822, datë 24.12.2021	Për një ndryshim në vendimin nr. 465, datë 26.7.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për krijimin e task-forcës për përmirësimin e nivelit të kontrollit të mjeteve motorike e rimorkiove të tyre”, të ndryshuar 20595
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 825, datë 24.12.2021	Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 109, datë 15.2.2017, të Këshillit të Ministrave, “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë e të Bordit të Akreditimit dhe për përcaktimin e tarifave për proceset e sigurimit të cilësisë në arsimin e lartë”, të ndryshuar..... 20596
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 826, datë 24.12.2021	Për mbulimin e shpenzimeve të mjekimit të znj. Egla Lleshaj..... 20597

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 827, datë 24.12.2021	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 171, datë 27.3.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullores ‘Për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit’”, të ndryshuar.....	20597
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 828, datë 24.12.2021	Për miratimin e dokumentacionit shoqërues të formularit, afateve dhe procedurës së shqyrtimit të kërkesës për pajisje me deklaratë, si dhe të deklaratës për arritjen e fazës së zhvillimit përfundimtar të kërkimit shkencor për burimet gjenetike.....	20598
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 829, datë 24.12.2021	Për miratimin e kriterëve të ushtrimit dhe të monitorimit të veprimtarive kërkimore-shkencore në fondin pyjor kombëtar.....	20601
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 830, datë 24.12.2021	Për masat lidhur me sigurimin e informacionit për konsumin e lëndës djegëse dhe shkarkimet e CO ₂ gjatë marketingut të automjeteve të reja.....	20605
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 831, datë 24.12.2021	Për rishpërndarje fondesh në buxhetin e vitit 2021, miratuar për Ministrinë e Kulturës dhe për Qendrën Kombëtare të Kinematografisë	20612
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 832, datë 24.12.2021	Për rishpërndarje fondesh në buxhetin e vitit 2021, miratuar për Ministrinë e Kulturës dhe për Qendrën Kombëtare të Kinematografisë	20612
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 833, datë 24.12.2021	Për mënyrën e ngritjes, administrimit, mirëmbajtjes së bazës së të dhënave për rininë, si dhe mënyrën e ndërveprimit të saj me bazat e tjera të të dhënave shtetërore.....	20618
Vendim i Bankës së Shqipërisë nr. 69, datë 22.12.2021	Për disa ndryshime në rregulloren “Për kredinë konsumatore dhe kredinë hipotekare”	20619
Vendim i Bankës së Shqipërisë nr. 70, datë 22.12.2021	Për dhënien e miratimit paraprak për zotërimin e pjesëmarrjes influencuese (të kontrollit të tërthortë) në kapitalin aksionar të “Bankës Amerikane të Investimeve” sh.a.....	20621
Udhëzim i Bankës së Shqipërisë nr. 3, datë 22.12.2021	Për raportimin e veprimeve të këmbimeve valutore	20621



LIGJ
Nr. 125/2021

**PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES
NDËRMJET REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË DHE MBRETËRISË SË
BASHKUAR TË BRITANISË SË MADHE,
DHE IRLANDËS SË VERIUT MBI
TRANSFERIMIN E PERSONAVE
TË DËNUAR**

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet marrëveshja ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Mbretërisë së Bashkuar të

**MARRËVESHJE NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE
MBRETËRISË SË BASHKUAR TË BRITANISË SË MADHE DHE
IRLANDËS SË VERIUT MBI TRANSFERIMIN E PERSONAVE TË
DËNUAR**

Republika e Shqipërisë (në vijim referuar si “Shqipëria”) dhe Mbretëria e Bashkuar e Britanisë së Madhe dhe Irlandës së Veriut (në vijim referuar si “Mbretëria e Bashkuar”) bashkërisht të referuara si “Palët”;

Duke marrë në konsideratë zhvillimet në marrëveshjet ndërkombëtare të transferimit të të dënuarve;

Me dëshirën për të siguruar që sa herë të jetë e mundur të dënuarit shtetas të huaj të kryejnë dënimin e tyre në vendin e vet;

Duke riafirmuar respektimin e të drejtave të njeriut gjatë trajtimit të personave të dënuar, kanë rënë dakord si më poshtë :

Britanisë së Madhe, dhe Irlandës së Veriut mbi transferimin e personave të dënuar, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji dhe është pjesë përbërëse e tij.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 16.12.2021.

Shpallur me dekretin nr. 13400, datë 24.12.2021, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Ilir Meta.



Neni 1

PËRKUFIZIME

Për qëllime të kësaj Marrëveshjeje:

- (a) "Shtet transferues" nënkupton Shtetin nga i cili personi i dënuar mund të transferohet ose është transferuar;
- (b) "Shtet marrës" nënkupton Shtetin në të cilin personi i dënuar mund të transferohet ose është transferuar;
- (c) "Person i dënuar" nënkupton një person, i cili kërkohet të mbahet nën arrest në burg ose në çdo institucion tjetër në Shtetin transferues në bazë të vendimit të marrë nga gjykata e Shtetit transferues për shkak të një vepre penale;
- (d) "Dënim" nënkupton çdo dënim ose masë që përfshin heqjen e lirisë të urdhëruar nga një gjykatë e Shtetit transferues për një periudhë kohe të kufizuar ose të pakufizuar për shkak të një vepre penale;
- (e) "Vendim" nënkupton një vendim ose urdhër të një gjykate që jep një dënim; dhe
- (f) "Shtetas" nënkupton:
 - (i) në lidhje me Mbretërinë e Bashkuar, një shtetas anglez ose çdo person, transferimin e të cilit Qeveria e Mbretërisë së Bashkuar e çmon të përshtatshëm, duke pasur parasysh çdo lidhje të ngushtë që ai person ka me Mbretërinë e Bashkuar
 - (ii) në lidhje me Shqipërinë, një person i cili ka shtetësinë shqiptare;

**Neni 2****PARIME TË PËRGJITHSHME**

1. Palët i ofrojnë njëra-tjetrës nivelin më të gjerë të bashkëpunimit në lidhje me transferimin e personave të dënuar në përputhje me dispozitat e kësaj Marrëveshjeje.
2. Ndërmjet Palëve, kjo Marrëveshje ka përparësi mbi çdo Marrëveshje shumëpalëshe që rregullon transferimin e personave të dënuar, në të cilat të dyja Palët mund të jenë palë.
3. Kur të dyja Palët bien dakord dhe në përputhje me dispozitat e kësaj Marrëveshjeje, një person i dënuar mund të transferohet nga territori i Shtetit transferues në territorin e Shtetit marrës me pëlqimin e personit të dënuar ose pa pëlqimin e personit të dënuar kur është lëshuar një urdhër për deportimin, dëbimin ose largimin, me qëllim që personi i dënuar të vazhdojë kryerjen e dënimit të dhënë nga Shteti transferues.
4. Transferimi i personave të dënuar mund të kërkohet nga Shteti transferues ose Shteti marrës.
5. Palët mund të lidhin një Memorandum Mirëkuptimi që rregullon zbatimin e kësaj Marrëveshjeje.

Neni 3**KUSHTET PËR TRANSFERIM**

Personat e dënuar mund të transferohen sipas kësaj Marrëveshjeje vetëm në kushtet e mëposhtme:

- (a) personi i dënuar është shtetas i Shtetit marrës për qëllime të kësaj Marrëveshjeje;
- (b) personi i dënuar jep pëlqimin për transferimin ose është subjekt i një urdhri për dëbim, deportim ose largim nga Shteti transferues;
- (c) vendimi është përfundimtar dhe asnjë procedim tjetër ligjor që lidhet me veprën ose ndonjë vepër tjetër të kryer nga personi i dënuar nuk është në proces në Shtetin transferues;



- (d) veprimet ose mosveprimet për të cilat është dhënë dënimi, përbëjnë një vepër penale sipas ligjit të Shtetit marrës ose do të përbënin një vepër penale nëse kryhej në territorin e tij;
- (e) personi i dënuar ka ende të paktën 6 muaj dënim për të kryer në kohën kur merret kërkesa për transferim; në raste të veçanta, Palët mund të bien dakord për transferimin edhe nëse personi i dënuar ka më pak se 6 muaj dënim për të vuajtur; dhe
- (f) Shteti transferues dhe marrës bien dakord për transferimin.

Neni 4

PROCEDURAT PËR TRANSFERIM

1. Kërkesat për transferim dhe përgjigjet bëhen me shkrim ndërmjet autoriteteve përkatëse.
2. Nëse shteti marrës kërkon transferimin e personit të dënuar, ai duhet t'i japë informacionin e mëposhtëm, kur është e mundshme, shtetit transferues me kërkesën me shkrim për transferimin;
 - (a) emrin, datën dhe vendin e lindjes së personit të dënuar;
 - (b) vendndodhjen e personit të dënuar; dhe
 - (c) adresën e përhershme të personit të dënuar në Shtetin marrës.
3. Nëse Shteti transferues kërkon transferimin e një personi të dënuar ose, pas marrjes së një kërkesë për transferim, sipas paragrafit 2 të këtij neni, është i gatshëm në parim, për të shqyrtuar kërkesën për transferim të një personi të dënuar, ai informon Shtetin marrës me shkrim dhe i jep informacionin e mëposhtëm (kur është e mundshme):
 - (a) emrin, datën dhe vendin e lindjes, si dhe fotografinë e personit të dënuar;
 - (b) emrin dhe mbiemrin e nënës dhe babait të personit të dënuar;



- (c) adresën e përhershme dhe aktuale të personit të dënuar në Shtetin marrës;
 - (d) dokumentacionin identifikues;
 - (e) vendndodhjen e personit të dënuar në Shtetin transferues;
 - (f) informacionin në lidhje me zbatimin, natyrën, kohëzgjatjen, datën e fillimit të dënimit, datën e përfundimit të dënimit, kohëzgjatjen e periudhës së kryer nga personi i dënuar (duke përfshirë paraburgimin), çdo falje të fituar dhe datën e lirimit me kusht;
 - (g) një kopje të aktakuzës dhe argumentimin e dënimit nga gjyqtari, si dhe informacionin rreth bazës ligjore mbi të cilin është bazuar;
 - (h) një kopje të urdhrit për ekzekutimin e dënimit;
 - (i) kur është e mundur, një kopje të kërkesës për transferim të personit të dënuar ose një kopje të urdhrit të deportimit ose largimit;
 - (j) çdo informacion tjetër, duke përfshirë raportet mjekësore ose sociale mbi personin e dënuar, të cilat mund të jenë të rëndësishme për transferimin e personit të dënuar dhe për vazhdimin e zbatimit të dënimit;
 - (k) një kopje të çdo opinionit me shkrim të bërë nga personi i dënuar në pajtim me paragrafin 2, germa “c” të nenit 8 të kësaj Marrëveshjeje.
4. Përkthimi i dokumenteve është përgjegjësi e Shtetit transferues.
5. Nëse Shteti marrës, pasi të ketë shqyrtuar informacionin e dhënë nga Shteti transferues, është i gatshëm të procedojë me transferimin, ai informon Shtetin transferues me shkrim dhe jep informacionin e mëposhtëm:
- (a) një deklaratë që tregon se personi i dënuar është shtetas i Shtetit marrës për qëllime të kësaj Marrëveshjeje;



- (b) një deklaratë që konfirmon efektin e çdo përshtatjeje të dënimit në pajtim me nenin 7 të kësaj Marrëveshjeje;
 - (c) kur njohja e dënimit është urdhëruar nga gjykata, një kopje të vendimit të gjykatës që njeh dënimin;
 - (d) një kopje të ligjit përkatës të Shtetit marrës, i cili parashikon se veprimet ose mosveprimet për shkak të të cilave është dhënë dënimi në Shtetin transferues përbëjnë një vepër penale sipas ligjit të Shtetit marrës ose do të përbënin një vepër penale nëse do të ishin kryer në territorin e tij;
 - (e) një deklaratë për çdo akuzë, dënim apo hetim penal në proces, në lidhje me personin e dënuar;
6. Nëse Shteti transferues është i gatshëm të procedojë me transferimin, ai do ti japë Shtetit marrës miratimin e tij me shkrim për kushtet e transferimit.
7. Kur Palët kanë rënë dakord për transferimin, ato do të marrin masa për transferimin e personit të dënuar.
8. Dorëzimi i personit të dënuar nga autoritetet e Shtetit transferues tek ato të Shtetit marrës kryhet në datën dhe vendin e rënë dakord nga të dyja Palët.
9. Nëse secila nga Palët vendos që të mos vazhdojë ose të mos bjerë dakord për transferimin, ajo do të informojë Palën tjetër për vendimin e saj me shkrim sa më shpejt të jetë e mundur.

Neni 5

EFEKTI I TRANSFERIMIT PËR SHTETIN TRANSFERUES

1. Marrja në dorëzim e personit të dënuar nga autoritetet e Shtetit marrës ka efektin e pezullimit të zbatimit të dënimit nga autoritetet në Shtetin transferues.



2. Shteti transferues nuk zbaton dënimin, nëse Shteti marrës çmon që zbatimi i dënimit të ketë përfunduar.

Neni 6

RUAJTJA E JURIDIKSIONIT

Shteti transferues ruan juridiksion ekskluziv për rishikimin e vendimit gjyqësor dhe të dënimit.

Neni 7

VAZHDIMI I ZBATIMIT TË DËNIMIT

1. Kur dënimi i dhënë nga shteti transferues është në pajtim me ligjet e Shtetit marrës, shteti marrës pasi e njeh gjykimin, zbaton dënimin sikur dënimi të ishte dhënë në Shtetin marrës.
2. Shteti marrës nuk do ta konvertojë dënimin në një dënim të ri, por mundet që me marrëveshjen e Shtetit transferues, të përshtasë dënimin si më poshtë:
 - (a) Kur dënimi e kalon dënimin maksimal të parashikuar në Shtetin marrës për një vepër penale të ngjashme, Shteti marrës mund ta ulë dënimin në dënimin maksimal të parashikuar në legjislacionin e Shtetit marrës për atë vepër penale.
 - (b) Kur dënimi nuk është një dënim me burgim të përjetshëm dhe zbatimi i dënimit në Shtetin marrës rezulton në një datë të mëvonshme lirimi me kusht, Shteti marrës mund ta përshtasë dënimin e përgjithshëm, duke e përafuar datën e lirimit me kusht me atë të Shtetit transferues.
 - (c) Kur është dhënë një dënim me burgim të përjetshëm nga gjykata që ka dhënë dënimin në Shtetin transferues dhe ajo gjykatë ka specifikuar një periudhë që duhet të kryhet me burgim përpara se personi të konsiderohet për lirim me kusht, atëherë Shteti marrës mund ta përshtasë dënimin në një kohëzgjatje të tillë që të sigurojë se data e lirimit me kusht në Shtetin marrës të mos jetë më pak se periudha e specifikuar me burgim, e përcaktuar në gjykatë nga Shteti transferues.
3. Shteti transferues ruan të drejtën ta tërheqë kërkesën për transferim, nëse nuk është i kënaqur me përshtatjen e propozuar të dënimit në çdo rast.



4. Dënimi që do të zbatohet në Shtetin marrës nuk do të rëndojë, në natyrë ose kohëzgjatje, sanksionin e vendosur në Shtetin transferues.
5. Vazhdimi i zbatimit të dënimit pas transferimit rregullohet nga ligjet dhe procedurat e Shtetit marrës, duke përfshirë ato që rregullojnë kushtet e burgimit, kufizimit ose të llojeve të tjera të heqjes së lirisë, si dhe ato që parashikojnë uljen e periudhës së burgimit, kufizimit ose të ndonjë heqjeje tjetër lirie me kusht, lirimit me kusht, ulje dënimi ose të tjera.
6. Shteti marrës ndryshon ose përfundon zbatimin e dënimit pas informimit për ndonjë vendim nga Shteti transferues për faljen e personit të dënuar ose për ndonjë vendim ose masë tjetër të Shtetit transferues që rezulton në shuarjen ose uljen e dënimit.
7. Shteti marrës i jep informacionin e mëposhtëm Shtetit transferues në lidhje me vazhdimin e zbatimit të dënimit:
 - (a) kur ka përfunduar dënimi;
 - (b) nëse personi i dënuar është arratisur nga burgu përpara përfundimit të dënimit;
 - (c) nëse personi i dënuar është i paaftë të përfundojë dënimin për ndonjë arsye; ose,
 - (d) një raport të posaçëm, nëse kërkohet nga Shteti transferues.

Neni 8

TË DREJTAT E PERSONAVE TË DËNUAR

1. Një person i dënuar mund të shprehë ndaj Shtetit transferues ose ndaj Shtetit marrës, interes për t'u transferuar sipas kësaj Marrëveshjeje.
2. Një person i dënuar, transferimi i të cilit kërkohet sipas kësaj Marrëveshjeje:
 - (a) informohet nga Shteti transferues mbi përmbajtjen e kësaj Marrëveshjeje;
 - (b) i shpjegohen me shkrim kushtet e transferimit në gjuhën e personit të dënuar;
 - (c) i jepet mundësia të paraqesë një opinion me shkrim pranë autoriteteve të Shtetit transferues përpara se Shteti transferues të japë pëlqimin e tij me shkrim ndaj kushteve të transferimit, brenda kuptimit të paragrafit 6 të nenit 4.

**Neni 9****TRAJTIMI I PERSONAVE TË DËNUAR**

Çdo Palë trajton personat e dënuar të transferuar sipas kësaj Marrëveshjeje, në përputhje me detyrimet e zbatueshme ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, veçanërisht në lidhje me të drejtën ndaj jetës dhe ndalimin kundër torturës dhe trajtimit ose dënimit mizor, çnjerëzor ose degradues.

Neni 10**NDJEKJA PENALE PËR VEPRA TË TJERA**

1. Një person i dënuar, i transferuar sipas dispozitave të kësaj Marrëveshjeje, nuk ndiqet penalisht, dënohet ose ndalohet me qellim kryerjen e një dënimi ose urdhri ndalimi për ndonjë veprë penale të kryer përpara transferimit, të ndryshme nga ajo për të cilën është vendosur dënimi që duhet të zbatohet; gjithashtu, personave të dënuar nuk do t'u kufizohet liria personale për ndonjë arsye tjetër, përveç rrethanave të mëposhtme:
 - (a) kur Shteti transferues e autorizon këtë, në pajtim me paragrafin 2 të këtij neni; ose
 - (b) kur personi i dënuar, pasi të ketë pasur mundësinë për t'u larguar nga territori i Shtetit marrës, nuk e ka bërë këtë brenda 45 ditëve nga përfundimi i dënimit ose nëse personi i dënuar është kthyer në Shtetin marrës pasi të jetë larguar prej tij.
2. Sipas nënparagrafit 1, germa "a" të këtij neni, Shteti marrës i paraqet një kërkesë për autorizim Shtetit transferues. Kërkesa për autorizim shoqërohet nga të gjitha dokumentet përkatëse dhe vërtetim ligjor të ndonjë deklaratë të bërë nga personi i dënuar. Autorizimi mund të jepet nga Shteti transferues, kur vepra për të cilën kërkohet, do të ishte e ekstradueshme sipas ligjit të Shtetit transferues ose kur ekstradimi do të përjashtohet vetëm për shkak të kohëzgjatjes së dënimit.

**Neni 11****TRANSITI I PERSONAVE TË DËNUAR**

Nëse një Palë transferon një person të dënuar për ose nga një shtet i tretë, Pala tjetër do të bashkëpunojë për lehtësimin e transitit të këtij personi të dënuar nëpërmjet territorit të saj. Pala që synon të bëjë një transferim të tillë do t'i japë njoftim paraprak Palës tjetër në lidhje me këtë transit. Ky nen nuk cenon të drejtën e ndonjë Pale për të refuzuar dhënien e transitit në një rast të veçantë.

Neni 12**ZBATIMI TERRITORIAL**

Kjo Marrëveshje zbatohet:

- (a) në lidhje me Shqipërinë, për territorin e Republikës së Shqipërisë; dhe
- (b) në lidhje me Mbretërinë e Bashkuar, në territorin e Mbretërisë së Bashkuar të Britanisë së Madhe dhe Irlandës së Veriut dhe Ishullit të Man-it; dhe në çdo territor tjetër për marrëdhëniet ndërkombëtare të të cilit Mbretëria e Bashkuar është përgjegjëse dhe në të cilin kjo Marrëveshje do të jetë shtrirë me marrëveshje të ndërsjellë ndërmjet Palëve me anë të shkëmbimit të notave;

Neni 13**ZBATIMI I PËRKOSSHËM**

Kjo Marrëveshje është e zbatueshme për transferimin e personave të dënuar të cilët janë dënuar para ose pas hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje.



Neni 14

ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE

Çdo mosmarrëveshje ndërmjet Palëve që lind nga/ose në lidhje me këtë Marrëveshje do të zgjidhet me anë të rrugëve diplomatike.

Neni 15

DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

1. Secila prej Palëve njofton tjetrën në lidhje me përfundimin e procedurave të tyre përkatëse të brendshme kushtetuese dhe ligjore të kërkuara për të mundësuar hyrjen në fuqi të kësaj Marrëveshjeje.
2. Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi në datën e njoftimit të fundit të përmendur në paragrafin 1 të këtij neni.
3. Secila Palë mund të përfundojë këtë Marrëveshjeje në çdo kohë me anë të një njoftimi me shkrim drejtuar Palës tjetër. Ky përfundim do të hyjë në fuqi me mbarimin e një periudhe gjashtë mujore pas datës së marrjes së njoftimit.
4. Pavarësisht nga ndonjë përfundim, kjo Marrëveshje dhe çdo garanci ose detyrim i dhënë sipas saj, do të vazhdojë të aplikohet për zbatimin e dënimeve të personave të dënuar të cilët janë transferuar sipas kësaj Marrëveshjeje përpara datës në të cilën ky përfundim hyn në fuqi.

NË DËSHMI TË KËSAJ, të nënshkruarit, duke qenë të autorizuar sipas rregullave për këtë nga Qeveritë e tyre përkatëse, kanë nënshkruar këtë Marrëveshje.

BËRË në Londër në dy kopje, më 26 Korrik 2021, në gjuhën shqipe dhe angleze, ku secili tekst është njëllor autentik.

PËR REPUBLIKËN
E SHQIPËRISË

PËR MBRETËRINË E BASHKUAR TË
BRITANISË SË MADHE DHE
IRLANDËS SË VERIUT



SHTOJCË

SHPJEGIME MBI ZBATIMIN E NENIT 7
TË MARRËVESHJES PËR TRANSFERIMIN E
TË BURGOSURVE (PTA) NDËRMJET
QEVERISË SË MBRETËRISË SË BASHKUAR
TË BRITANISË SË MADHE DHE IRLANDËS
SË VERIUT, DHE REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË

Kjo Marrëveshje për Transferimin e të Burgosurve (PTA) parashikon transferimin e personave të dënuar ndërmjet Mbretërisë së Bashkuar dhe Shqipërisë (referuar si “Marrëveshja”). Neni 7 i Marrëveshjes është ndryshuar, për shkak se Mbretëria e Bashkuar dhe Shqipëria kanë dispozita të ndryshme për lirimin e parakohshëm. Për të siguruar që të burgosurit e transferuar, sipas Marrëveshjes të mos jenë në disavantazh të padrejtë vetëm si pasojë e transferimit, Palët në Marrëveshje kanë rënë dakord, që Shteti pritës mund të përshtatë dënimin e përgjithshëm për të harmonizuar më mirë datën e lirimit me kusht me atë të Shtetit transferues.

- Për ta bërë këtë, paragrafi 1 i nenit 7, i mundëson Shtetit pritës të zbatojë dënimin e dhënë në Shtetin transferues sikur të ishte dhënë në shtetin pritës. Kjo i mundëson Shtetit pritës të trajtojë dënimin në të njëjtën mënyrë, si një dënim i brendshëm për qëllime të zbatimit të dënimit dhe në zbatimin e masave të tij të lirimit.

- Paragrafi 2, në mënyrë specifike, përjashton mundësinë e konvertimit të dënimit. Për këtë qëllim, konvertimi i një dënimi nënkupton një ushtrim të rindënimit, ku Shteti pritës ka detyrimin ligjor lidhur me njohjen e fajësisë dhe të dënimit në Shtetin transferues, por është në gjendje të zëvendësojë dënimin e dhënë në Shtetin transferues, me një dënim që do të ishte dhënë nga gjykatat e tij, nëse vepra do të ishte kryer në territorin e tij. Megjithatë konvertimi i një dënimi është i përjashtuar, paragrafi 2 përcakton rrethanat e kufizuara në të cilat një dënim mund të përshtatet ose të reduktohet. Përshtatja e dënimit i mundëson uljen apo ndryshimin e vendimit dënim që njihet në rrethanat e kufizuara të përcaktuara në nënparagrafë.

- Paragrafi 2(a) lejon që një dënim të përshtatet, kur dënim i dhënë në Shtetin transferues tejkalon dënimin maksimal të parashikuar nga ligji i Shtetit pritës për të njëjtën vepër. Një përshtatje e tillë

kufizohet në periudhën maksimale të përcaktuar nga ligji në shtetin pritës.

- Paragrafi 2(b) lejon Shtetin pritës të përshtatë (zvogëlojë) dënimin me atë që do të jepte një datë lirim që është e ngjashme ose ekuivalente me atë të zbatueshme në Shtetin transferues. Për shembull, një i burgosur i dënuar me 9 vjet burgim, i cili do të lirohej automatikisht në Shtetin transferues pas vuajtjes së 4 vjetëve e 6 muajve (gjysma e dënimit), mund të përshtatë dënimin prej 9 vjetësh me një dënim prej 7 vjetësh në shtetin pritës, ku lrimi është caktuar në dy të tretat, kjo do të parashikonte lirim pas vuajtjes së 4 vjetëve e 7 muajsh.

- Paragrafi 2(c) lejon që një dënim i përjetshëm të konvertohet në një dënim me afat të caktuar. Në Mbretërinë e Bashkuar, kur një gjykatë vendos një dënim me burgim të përjetshëm, cakton, gjithashtu, një afat minimal (i njohur gjithashtu si tarifa – “periudha e specifikuar”. Afati minimal është pjesa e vuajtjes së dënimit. Pasi të ketë përfunduar afati minimal, i burgosuri mund të konsiderohet për lirim. Meqenëse afati minimal në Mbretërinë e Bashkuar përcaktohet nga gjykatat, është mendimi i autoriteteve britanike se çdo rritje e këtij afati do të përbënte një përkeqësim të dënimit. Ndaj, paragrafi 2(c) lejon që një dënim i përjetshëm të përshtatet me një dënim me afat të caktuar, i cili përafron periudhën e burgimit të dënimit me afatin minimal të dënimit në Mbretërinë e Bashkuar, në mënyrë që data e lirimit me kusht të mos jetë më e vogël se periudha e specifikuar.

- Paragrafi 3 lejon që Shteti transferues të tërheqë kërkesën për transferim, nëse nuk pajtohet me miratimin e propozuar të dënimit.

- Paragrafi 4 parandalon rëndimin e dënimit në çdo rrethanë.

Tabela e përshtatjes së dënimit bashkangjitur më poshtë ka si qëllim të mbështesë Gjykatat në Shqipëri në caktimin e një dënimi të përshtatshëm në përputhje me kërkesat e nenit 7(1)(b) dhe (c) të Marrëveshjes. Synimi është që të sjellë masat e aplikueshme të lirimit në Shqipëri në harmoni të ngushtë me ato të Mbretërisë së Bashkuar, duke përshtatur gjatësinë e masës së dënimit që do të kryhet në Shqipëri. Nuk synon të kopjojë masat e lirimit britanik dhe adaptimin e dënimit, në përputhje me nenin 7(1)(b) dhe (c) të kësaj marrëveshje, mund të mos rezultojë në një kopje ekzakte të datës së lirimit me kusht në Mbretërinë e Bashkuar.



Asgjë në këtë aneks nuk kërkon që Gjykata të përshtatë një dënim. Kjo mbetet çështje për t'u përcaktuar nga Gjykata rast pas rasti.

Tabela e përshtatjes së dënimit

DËNIMI I DHËNË NË MBRETËRINË E BASHKUAR	PERIUDHA PËR T'U VUAJTUR DERI NË DATËN E LIRIMIT ME KUSHT NË MB (gjysma e dënimit)	DËNIMI I PËRAFËRT EKVIVALENT NË SHQIPËRI
5 vite	2 vite dhe 6 muaj	3 vite dhe 4 muaj
6 vite	3 vite	4 vite dhe 6 muaj
7 vite	3 vite dhe 6 muaj	5 vite dhe 3 muaj
8 vite	4 vite	6 vite
9 vite	4 vite dhe 6 muaj	6 vite dhe 9 muaj
10 vite	5 vite	7 vite dhe 6 muaj
11 vite	5 vite dhe 6 muaj	8 vite dhe 3 muaj
12 vite	6 vite	9 vite
13 vite	6 vite dhe 6 muaj	9 vite dhe 9 muaj
14 vite	7 vite	10 vite dhe 6 muaj
15 vite	7 vite dhe 6 muaj	11 vite dhe 3 muaj
16 vite	8 vite	12 vite
17 vite	8 vite dhe 6 muaj	12 vite dhe 9 muaj
18 vite	9 vite	13 vite dhe 6 muaj
19 vite	9 vite dhe 6 muaj	14 vite dhe 3 muaj
20 vite	10 vite	15 vite
21 vite	10 vite dhe 6 muaj	15 vite dhe 9 muaj
22 vite	11 vite	16 vite dhe 6 muaj
23 vite	11 vite dhe 6 muaj	17 vite dhe 3 muaj
24 vite	12 vite	18 vite
25 vite	12 vite dhe 6 muaj	18 vite dhe 9 muaj
26 vite	13 vite	19 vite dhe 6 muaj
27 vite	13 vite dhe 6 muaj	20 vite dhe 3 muaj
28 vite	14 vite	21 vite
29 vite	14 vite dhe 6 muaj	21 vite dhe 9 muaj
30 vite	15 vite	22 vite dhe 6 muaj

Onr 407

DEKRET
Nr. 13400, datë 24.12.2021

PËR SHPALLJE LIGJI

Në mbështetje të nenit 84, pika 1, dhe nenit 93 të Kushtetutës,

DEKRETOJ:

Shpalljen e ligjit nr. 125/2021, “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Mbretërisë së Bashkuar të Britanisë së Madhe, dhe Irlandës së Veriut mbi transferimin e personave të dënuar”.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Ilir Meta

LIGJ
Nr. 129/2021

PËR STATUSIN “FËMIJË NË PËRKUJDESJE TË REPUBLIKËS”

Në mbështetje të neneve 78, 81, pika 1, dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Objekti

Objekti i këtij ligji është përcaktimi i kritereve dhe procedurës për përfitimin e statusit “Fëmijë në



përkujdesje të Republikës”, si dhe i të drejtave e përfitimeve që rrjedhin nga ky status.

Neni 2 Qëllimi

Qëllimi i këtij ligji është marrja në mbrojtje dhe në përkujdesjen e shtetit të fëmijës, njëri ose të dy prindërit e të cilit apo, në mungesë të tyre, personi i ngarkuar ligjërisht me kujdestarinë e tij kanë humbur jetën në kushtet e përcaktuara nga ligji “Për statusin ‘Dëshmor i Atdheut’”, në përpjekje për mbrojtjen e pronës publike apo mbrojtjen e jetës së individit, si rezultat i një akti vetëmohimi ose patriotizmi, për shkak të plagëve të marra apo të sëmundjeve të shkaktuara si pasojë e kryerjes me përgjegjshmëri të detyrës dhe ushtrimit të profesionit në kushte të jashtëzakonshme apo të fatkeqësisë natyrore. Ky ligj garanton mirëqenien dhe zhvillimin e jetës së fëmijës nëpërmjet ndihmës dhe përkujdesjes efektive të shtetit, bazuar në interesin më të lartë të fëmijës.

Neni 3 Subjektet

Subjekte të këtij ligji janë personat të cilëve u jepet statusi “Fëmijë në përkujdesje të Republikës”, familjarët e tyre, organet e pushtetit qendror e të njëjësive të vetëqeverisjes vendore, që ngarkohen për ndjekjen dhe zbatimin e detyrimeve që rrjedhin nga ky ligj.

Neni 4 Përkufizime

Në kuptim të këtij ligji, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “Akt vetëmohimi” është veprimi ose mosveprimi i kryer me vullnet të plotë nga ana e një individit, pa kursyer edhe jetën e tij, në mbrojtje të interesave të shtetit, të mirës publike ose të jetës së personit.

2. “Dëshmor i Atdheut” ka të njëjtin kuptim sipas përcaktimit të dhënë në ligjin nr. 109/2018 “Për statusin ‘Dëshmor i atdheut’”.

3. “Personi i ngarkuar me përkujdesjen ndaj fëmijës” është kujdestari ligjor, i cili sipas ligjit apo një vendimi gjykatë i ofron fëmijës një mjedis familjar, kushte për mirërritje, përkujdesje fizike,

mbështetje emocionale dhe kushtet për arsimim e formim.

4. “Subjekte kërkuese” janë përfaqësues ligjorë të fëmijës së mitur për të cilin kërkohet që të jepet statusi “Fëmijë në përkujdesje të Republikës”, drejtues të organeve shtetërore dhe organizatave jofitimprurëse, si dhe përfaqësues të shoqërisë civile.

KREU II KRITERET PËR MARRJEN E STATUSIT “FËMIJË NË PËRKUJDESJE TË REPUBLIKËS”

Neni 5 Kriteret për marrjen e statusit “Fëmijë në përkujdesje të Republikës”

Gëzojnë të drejtën për marrjen e statusit “Fëmijë në përkujdesje të Republikës” kategoritë e mëposhtme të personave që nuk kanë mbushur ende moshën 18 vjeç:

a) fëmijët ose personat nën kujdestari të një personi të shpallur apo të njohur me statusin “Dëshmor i Atdheut”;

b) fëmijët ose personat nën kujdestari të shtetasve shqiptarë, të cilët kanë humbur jetën, qoftë edhe për shkak të plagëve të marra, në përpjekje për të ndihmuar popullsinë, për mbrojtjen e pronës publike ose për shpëtimin e mbrojtjen e jetës së individit, si rezultat i një akti vetëmohimi apo patriotizmi;

c) fëmijët ose personat nën kujdestari të shtetasve shqiptarë që kanë humbur jetën, qoftë edhe për shkak të plagëve apo të sëmundjeve të marra si pasojë e kryerjes me përgjegjshmëri të funksionit apo detyrës publike në kushte ose situata që lidhen me ngjarje të jashtëzakonshme apo të fatkeqësive natyrore, sipas përcaktimeve të legjislationit në fuqi.

Neni 6 Humbja apo përjashtimi nga statusi “Fëmijë në përkujdesje të Republikës”

Statusin “Fëmijë në përkujdesje të Republikës” nuk e përfiton ose në rast se e ka përfituar e humbet personi:

a) i dënuar me vendim gjykatë të formës së prerë për:



- i. krime kundër njerëzimit;
- ii. krime kundër rendit kushtetues;
- iii. veprimtari me qëllime terroriste;
- iv. vepra penale kundër pronës dhe interesave të shtetit;

b) për të cilin vërtetohet gjyqësisht se vendimi për njohjen e statusit është bazuar në dokumente të falsifikuara.

Neni 7

Dokumentet për marrjen e statusit “Fëmijë në përkujdesje të Republikës”

Për marrjen e statusit “Fëmijë në përkujdesje të Republikës” vlejnë si burime parësore vendimet e organeve publike të marra në kohën e ngjarjeve, aktet dhe ekspertizat mjekësore për vërtetimin e lidhjes shkak-pasojë të humbjes së jetës, çdo lloj dokumenti autentik, dëshmuar për statusin civil dhe lidhjen familjare të personit, si një prej rasteve të parashikuara në nenin 5 të këtij ligji.

Neni 8

Kërkesa për marrjen e statusit “Fëmijë në përkujdesje të Republikës”

1. Statusi “Fëmijë në përkujdesje të Republikës” jepet me vendim të Komisionit Qendror për dhënien e statusit “Fëmijë në përkujdesje të Republikës”, me kërkesë të paraqitur nga subjektet e interesuara si më poshtë:

- a) familjarë të fëmijës (prindër, vëllezër ose motra), kujdestari ose përfaqësuesi ligjor i fëmijës;
- b) përfaqësues të autorizuar të organeve të qeverisjes qendrore ose vendore;
- c) çdo organizatë joqeveritare me qëllim jofitimprurës, që ka për synim mbrojtjen dhe mirëqenien e fëmijëve.

2. Format i kërkesës, llojet e dokumenteve që paraqiten për marrjen e statusit “Fëmijë në përkujdesje të Republikës”, si dhe kushtet teknike të plotësimit të tyre përcaktohen me udhëzim të kryetarit të Komisionit Qendror të Statusit “Fëmijë në përkujdesje të Republikës”.

KREU III

TË DREJTAT QË RRJEDHIN NGA STATUSI “FËMIJË NË PËRKUJDESJE TË REPUBLIKËS”

Neni 9

Përfitim i statusit “Fëmijë në përkujdesje të Republikës”

Statusi “Fëmijë në përkujdesje të Republikës” përfitohet deri në moshën 18 vjeç dhe i siguron personit një trajtim të veçantë material e moral, sipas parashikimeve të këtij ligji, deri në moshën 25 vjeç, nëse ndjek arsimin e lartë. Pas kësaj moshe statusi ruhet gjatë gjithë jetës, por nuk jep të drejtë për trajtim të veçantë material, përveç shoqërimin, nderimit dhe përkujdesjes morale nga organet publike përkatëse, sipas parashikimit të pikës 2, të nenit 10 të këtij ligji.

Neni 10

Të drejtat që rrjedhin nga statusi “Fëmijë në përkujdesje të Republikës”

1. Personi, të cilit i jepet statusi “Fëmijë në përkujdesje të Republikës”, gëzon këto të drejta:

a) përfiton trajtim financiar mujor, që llogaritet në bazë të pagës mujore më të lartë të prindit apo kujdestarit ligjor që ka humbur jetën, pavarësisht nga periudha e sigurimit të të ndjerit, përkatësisht në masën:

i. 100 për qind për çdo fëmijë kur në ngarkim të personit që ka humbur jetën ka vetëm një fëmijë që gëzon statusin “Fëmijë në përkujdesje të Republikës”;

ii. 70 për qind për çdo fëmijë kur në ngarkim të personit që ka humbur jetën ka dy fëmijë që gëzojnë statusin “Fëmijë në përkujdesje të Republikës”;

iii. 50 për qind për çdo fëmijë kur në ngarkim të personit që ka humbur jetën ka tre fëmijë që gëzojnë statusin “Fëmijë në përkujdesje të Republikës”;

iv. 40 për qind për çdo fëmijë kur në ngarkim të personit që ka humbur jetën ka katër fëmijë që gëzojnë statusin “Fëmijë në përkujdesje të Republikës”;

v. 30 për qind për çdo fëmijë kur në ngarkim të personit që ka humbur jetën ka më shumë se katër fëmijë që gëzojnë statusin “Fëmijë në përkujdesje të Republikës”.



të Republikës”. Në këtë rast trajtimi financiar mujor për të gjithë fëmijët përfitues të mos tejkalojë shumën 150% të pagës më të lartë të prindit apo kujdestarit ligjor që ka humbur jetën.

Në rastin e përfitimit të trajtimit financiar sipas parashikimeve të ligjeve të tjera, ka të drejtë të zgjedhë trajtimin financiar më të favorshëm. Pagesa e trajtimit financiar sipas kësaj pike do të kryhet nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore;

b) përfiton shërbim falas shëndetësor e spitalor në institucionet shëndetësore publike apo kur është e nevojshme edhe private sipas përcaktimeve me vendim të Këshillit të Ministrave;

c) në sistemin arsimor parauniversitar përfiton trajtim financiar sipas kuadrit ligjor për përfitimin e bursave e të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore parauniversitare publike dhe tekste shkollore falas;

ç) përfiton bursë të plotë nga fondi i mbështetjes studentore dhe përjashtohet nga tarifa vjetore e shkollimit sipas kuadrit ligjor në fuqi kur fiton të drejtën e ndjekjes së një programi studimi në arsimin e lartë në institucionet publike të arsimit të lartë;

d) përfiton orientim profesional falas sipas kërkesës në fund të çdo cikli arsimor;

dh) përfiton mbështetje për një trajtim preferencial për punësim në administratën publike dhe/ose biznesin privat, në përfundim të studimeve të arsimit të lartë, sipas kushteve të përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave.

2. Personi që merr statusin “Fëmijë në përkujdesje të Republikës” ka gjithashtu të drejtë:

a) të përkujtojë sakrificën dhe vetëmohimin e prindërve të tij në kuadër të një ceremonie nën përgjegjësinë e organeve publike qendrore e lokale;

b) të organizohet në shoqata, qendra dhe fondacione jofitimprurëse, me synim vlerësimin e sakrificës dhe vetëmohimit të prindërve dhe dhënien e shembullit të brezat;

c) të bëhet pjesë, sipas përcaktimeve të Ceremonialit të Republikës së Shqipërisë, përmes një vendimi të Këshillit të Ministrave, e ceremonive dhe organizimeve madhore me rastin e festave kombëtare dhe atyre zyrtare.

3. Përfitimet sipas këtij neni mbulohen nga buxheti i shtetit.

KREU IV ORGANET E PARAQITJES SË KËRKESËS, SHQYRTIMIT DHE MARRJES SË VENDIMIT

Neni 11

Komisioni Qendror i Statusit “Fëmijë në përkujdesje të Republikës”

1. Pranë ministrisë përgjegjëse për çështjet sociale krijohet Komisioni Qendror i Statusit “Fëmijë në përkujdesje të Republikës”, si autoriteti që ka kompetencë dhënien e statusit “Fëmijë në përkujdesje të Republikës” pas shqyrtimit të kërkesave dhe propozimeve të paraqitura nga subjektet e përcaktuara në nenin 8 të këtij ligji.

2. Komisioni Qendror për Statusin “Fëmijë në përkujdesje të Republikës” është organ kolegjal *ad hoc*, i përbërë nga 7 anëtarë. Komisioni kryesohet nga ministri përgjegjës për çështjet sociale dhe në përbërje ka 4 anëtarë në nivel zëvendësministrash dhe 2 anëtarë nga organizatat e mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve ose të mbrojtjes së njeriut. Komisioni Qendror, për ushtrimin e përgjegjësisë të caktuara në ligj, përfiton një shpërblim financiar sipas legjislacionit në fuqi dhe mbështetet nga një staf teknik. Përgjegjësi i stafit teknik kryen edhe detyrën e sekretarit teknik të Komisionit Qendror.

Përbërja, rregullat e detajuara për organizimin dhe funksionimin e Komisionit Qendror dhe sekretariatit përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për çështjet sociale.

3. Komisioni Qendror shqyrton dhe vendos për çdo kërkesë apo propozim brenda 30 ditëve nga depozitimi i tyre në mënyrë shkresore apo elektronike në sekretarinë e Komisionit, sipas përcaktimeve në udhëzimin e miratuar me vendim të Komisionit.

4. Komisioni Qendror raporton, të paktën 1 herë në vit, pranë Këshillit të Ministrave për punën e kryer në kuadër të kompetencave të tij.



KREU V
E DREJTA E ANKIMIMIT

Neni 12
Ankimimi

Kundër vendimit të Komisionit Qendror të Statusit “Fëmijë në përkujdesje të Republikës”, si dhe në rastet kur ky komision nuk shprehet brenda afatit të përcaktuar në nenin 11 të këtij ligji, subjektet e interesuara mund të paraqesin ankim pranë ministrit përgjegjës për çështjet sociale, i cili shprehet brenda 15 ditëve nga depozitimi i ankimit. Kundër urdhrimit të ministrit ose kur ministri nuk shprehet brenda afatit të parashikuar në këtë pikë paraqitet ankim pranë gjykatës kompetente, në përputhje me rregullat e parashikuara nga legjislacioni në fuqi për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative.

KREU VI
DISPOZITA KALIMTARE DHE TË
FUNDIT

Neni 13
Dispozitë kalimtare

1. Personat sipas kategorive të parashikuara në nenin 5, të këtij ligji, kanë të drejtën për të përfutuar statusin “Fëmijë në përkujdesje të Republikës” pavarësisht nëse prindi apo kujdestari ligjor ka humbur jetën përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji.

2. Gëzon të drejtën për të përfutuar statusin “Fëmijë në përkujdesje të Republikës” personi që nuk ka mbushur moshën 18 vjeç, prindi apo kujdestari ligjor i të cilit i përket kategorisë mjek apo infermier, që ka humbur jetën qoftë edhe përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji, si rezultat i infeksionit SARS-COVID-19, të marrë gjatë apo për shkak të kryerjes së detyrës në institucionet e specializuara/spitalet COVID-19.

Neni 14
Akte nënligjore

1. Ngarkohet Këshilli i Ministrave, që brenda 30 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të neneve 10 dhe 11, të këtij ligji.

2. Ngarkohet kryetari i Komisionit Qendror të Statusit “Fëmijë në përkujdesje të Republikës” që brenda 30 ditëve të nxjerrë udhëzime në zbatim të pikës 2, të nenit 8, të këtij ligji.

3. Ngarkohet Komisioni Qendror i Statusit “Fëmijë në përkujdesje të Republikës” që brenda 30 ditëve nga krijimi i Komisionit të nxjerrë vendim në zbatim të pikës 3, të nenit 11, të këtij ligji.

Neni 15
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 20.12.2021.

Shpallur me dekretin nr. 13402, datë 24.12.2021, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Ilir Meta.

DEKRET
Nr. 13402, datë 24.12.2021

PËR SHPALLJE LIGJI

Në mbështetje të nenit 84, pika 1, dhe nenit 93 të Kushtetutës,

DEKRETOJ:

Shpalljen e ligjit nr. 129/2021, “Për statusin Fëmijë në përkujdesje të Republikës”.

**PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Ilir Meta**



VENDIM
Nr. 814, datë 24.12.2021

**PËR KOMPENSIMIN FINANCIAR TË
PRONARËVE TË PASURIVE TË
PALUAJTSHME QË PREKEN NGA
NDËRTIMET E LEGALIZUARA**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 24, të ligjit nr. 20/2020, “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”, dhe të nenit 10, të ligjit nr. 133/2015, “Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronave”, me propozimin e zëvendëskryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kompensimin financiar të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, për sipërfaqet takuese, të zëna nga ndërtimet e legalizuara në drejtoritë vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës: Tiranë Veri, Tiranë Jug, Tiranë Rurale 1, Tiranë Rurale 2, Kamzë-Vorë, Elbasan, Zonat e Stimuluara, Vlorë, Gjirokastrë, Durrës, Lushnjë, Fier dhe Sarandë.

2. Masa e kompensimit është 43 287,27 (dyzet e tre mijë e dyqind e tetëdhjetë e shtatë presje njëzet e shtatë) m² dhe vlera e përgjithshme e kompensimit financiar është 436 983 853,04 (katërqind e tridhjetë e gjashtë milionë e nëntëqind e tetëdhjetë e tre mijë e tetëqind e pesëdhjetë e tre presje zero katër) lekë, sipas shtojcës 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

3. Për kompensimin financiar të pronarëve të pasurive të paluajtshme, që preken nga ndërtimet e legalizuara, sipas shtojcës 1, bashkëlidhur këtij vendimi, për pasuritë me numrat rendorë sipas kolonës 14, të shtojcës 1, përkatësisht, nr. 1, nr. 7, nr. 9, nr. 14, nr. 19, nr. 24, nr. 25, nr. 26, nr. 37, nr. 56, nr. 60, nr. 78, nr. 145, nr. 167, nr. 172, nr. 174 dhe nr. 186, sipas seksionit të veçantë (kolona 19), shuma e kompensimit financiar vihet në dispozicion nga Agjencia e Trajtitimit të Pronave, sipas pikës 3, të nenit 24, të ligjit nr. 20/2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”.

4. Për kompensimin e pronarëve përdoren po ato të ardhura që arkëtohen nga drejtoritë vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, si rrjedhojë e kalimit të pronësisë nëpërmjet shitjes së parcelës ndërtimore, si për pasuritë shtetërore, edhe për pasuritë e të tretëve, në favor të objekteve informale që legalizohen.

5. Drejtoritë vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës: Tiranë Veri, Tiranë Jug, Tiranë Rurale 1, Tiranë Rurale 2, Kamzë-Vorë, Elbasan, Zonat e Stimuluara, Vlorë, Gjirokastrë, Durrës, Lushnjë, Fier dhe Sarandë, të kryejnë ndryshimet përkatëse për këto pasuri në regjistrat e pasurive të paluajtshme.

6. Ngarkohen Agjencia Shtetërore e Kadastrës dhe Agjencia e Trajtitimit të Pronave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama



AGJENCIA SHTETËRORE E KADASTRËS

LISTA EMËRORE E SUBJEKTEVE QË PREKEN NGA NDËRTIMET INFORMALE TË KUALIFIKUARA, MASA DHE VLERA E SHPËRBLIMIT

Të dhënat e pasurisë së legalizuar						Gjendja juridike (pronësia)	Pjesa takues e në parcelë (m ²)	Sipërfaqja për kalim pronësie (m ²)	Numri i pronarëve që kompensohen	Kompensimi i pronarëve									
Nr. rendor	Emër	Atësi	Mbiemër	Leja e legalizimit						Emër	Atësi	Mbiemër	Nr. i pronave	Nr. i pasurisë	Masa e kompensimit (m ²)	Çmimi (lekë/m ²)	Shuma - vlera e kompensimit (lekë)	Seksioni i veçantë	
				Numër	Data														
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14	15	16	17	18.00	19	
TIRANË VERI																			
QARKU TIRANË, ZONA KADASTRALE 8120																			
1	EDMOND	ALI	LAMCELLARI	97220	31.03.2015	TË TRETËVE		121		XHEMAL		TURKU	1	5/263	4.3	29,106	125,155.80	KUFIZIM, MUNGON DOKUMENTACIONI NË ARKIV	
										ASTRIT	IBRAHIM	TURKU							
										SHKELQIM	BEDRI	TURKU							
										EDLIRA	BEDRI	TURKU							
										ALBAN	BEDRI	TURKU							
										FLORINDA	MAHMUT	AGALLIU							
										GENC	MAHMUT	AGALLIU							
										FLUTURA	IBRAHIM	CANKJA							
										LIRIJE	HYSEN	DERHEMI							
										MIMOZA	IBRAHIM	FRASHERI							
PAQIZE	IBRAHIM	MULLAJ IBRAHIMI																	
SEZAI	HYSEN	TURKU																	
QARKU TIRANË, ZONA KADASTRALE 3292																			
2	SADIK	MUS	TAFILAKU	730892	27.08.2015	SHTET+TË TRETËVE		458.5		VAJE	HYSEN	XHAFI	3	45/48	458.5	3,413	1,564,860.50		
QARKU TIRANË, ZONA KADASTRALE 8340																			
3	REXHEP LUTFI EDUKAT GAZMIR	LUTFI REXHEP REXHEP	SHEHI SHEHI SHEHI	110	04.02.2021	TË TRETËVE+SHETE 1		319		1	DIELLI		SHEHU	4	1/432	319	30,158	9,620,402.00	
										2	HANA		SINA(SHEHU)						
										3	LAURETA		SEREZ(SHEHU)						
										4	LUMTURI		KUCI(SHEHU)						
										5	TEUTA		URUC(SHEHU)						
										6	VIOLETA		TOPI(SHEHU)						
										7	YLLI		SHEHU						
QARKU TIRANË, ZONA KADASTRALE 8380																			
4	MIHAL	PANO	TASE	1233190	31.08.2020	TË TRETËVE		14		ASIJE		ZELA	5	6/479	14	66,969	937,566.00		
										TEFIK	IRFAN	TERSHANA							
										HASAN		ZELA							
QARKU TIRANË, ZONA KADASTRALE 8180																			
5	BUJAR	IDRIZ	SHOKU	77339	09.06.2015	TË TRETËVE		355		KRYEGJYSHATA BOTËRORE E BEKTASHIANE			6	7/240	1.4	31,270	43,778.00		
										GENTI	HAXHI	SAUKU							
										ARTAN	HAXHI	SAUKU							
										MERITA	HAXHI	BRUCI(SAUKU)							
HANA	HAXHI	SAUKU																	
QARKU TIRANË, ZONA KADASTRALE 8340																			
6	EDMOND	PREL	GJOKA	961	19.4.2021	SHTET+TË TRETËVE		2014		DHURATA	MEHMET	FAJA	8	5/1178	65.3	30,158	1,969,317		
										HAMDI	MEHMET	FAJA							
										HASAN	MEHMET	FAJA							



18	ARTAN	BAJRAM	DYRKA	79602	30.03.2016	TË TRETËVE+SHTET	50	ARBEN	BIBA	24	4/194	50	30158	1,507,900.00	DIFERENCA SIP DOKUMENT FAKT TOTAL 270M2
								HAJDAR	KRUJA						
								LULJETA	GJINALI						
								LUTFIJE	ZAKJA						
								NAILE	HYSA						
								NAZMIE	SKENDERI						
								NURIE	ISMAILI						
								SKENDER	KRUJA						
			XHAVIT	KRUJA											
QARKU TIRANË, ZONA KADASTRALE 8120, ASHK TIRANË															
19	REFAT	MEHMET	DULE	125	25.05.2021	TË TRETËVE	293	ABDURAHMAN	HARASANI	25	9/2094	293	29,106	8,528,058.00	KA DIFERENCA DOKUMENT-FAKT
								GEZIM	HARASANI						
								MEREME	HARASANI						
								MUSTAFA	HARASANI						
								SANIE	HARASANI						
								SHAHE	HARASANI						
								XHAFER	HARASANI						
								ZYBEJTE	HARASANI						
AFERDITA	HARASANI														
BUJAR	HARASANI														
QARKU TIRANË, ZONA KADASTRALE 8340, ASHK TIRANË															
20	LAVDRIM	MENTOR	KOCI	997265	20.04.2017	TË TRETËVE	245	AGIM	RADUCI	26	9/1209	245	30158	7,388,710.00	BLOKOHET NË FAVOR TË SHQËRISË *ALBAN- TIRANA* SHPK KUFIZIM I VEPRIMEVE
								ARJAN	MAHO						
								BUJAR	DUKA						
								EQEREM	MUCA						
								FATMIR	MAHO						
								LUMTURI	MUCA						
								PELLUMB	RADUCI						
								PRANVERA	RADUCI						
								SABAHET	CANAKU						
								SERVETE	LAMCE						
								VIOLETA	AJDINI						
								NAXHUE	MUCA						
								BARDHYL	MUCA						
								GANIMET	PEQINI						
								RUDINA	VRAPI						
KRENAR	SPAHILLARI														
JONIDA	SPAHILLARI														
QARKU TIRANË, ZONA KADASTRALE 8210															
21	KRISTAQ	MIHAL	ALLABAKU	10486	07.05.2012	SHTET + TË TRETËVE	165.61	AISHE	HAMDI	DUÇELLARI	27	1/643	165.61	38614	6,394,864.54
								ERGEST	EVIRON	DUÇELLARI					
								ARDITA	ERIVON	DUÇELLARI					
QARKU TIRANË, ZONA KADASTRALE 8360															
22	QAMILE	HAMDI	TRESA	1233596	20.10.2020	SHTET+TË TRETËVE	64	BUJAR	PETRELA	28	6/394	64	66969	4,286,016.00	
								MYRSHIT	VORPSI						



									YLBER		PETRELA						
									SEIT		PETRELA						
									HALIL		PETRELA						
									ROLAND		BEJA						
	PETRIT	FEJZULLA	IRESA						ELVANA	ABDULLA	DOBROLISHTI						
									BESNIK	RESHAT	BEJA						
									LULZIM	RESHAT	BEJA						
									MAJLINDA	SULEJMAN	TIVARI						
									ENIS	SHKELQIM	SPAHIU						
									RAZUJE		PETRELA						
									ANILA	RAMAZAN	PETRELA						
									HATIXHE	MEHMET	KELLEZI						
									ENKI	ALBERT	KAZIU						
	ARDIAN	FEJZULLA	TRESA						SUZANA	MEHMET	KAZIU						
									KLAJDI	ALBERT	KAZIU						
									ALBERT	LUTFI	KAZIU						
									GENTI		PETRELA						
									KUJTIM	MEHMET	KELLEZI						
									LILJANA	SULEJMAN	BULKU						
									SILVANA	SABRI	ISHMI						
									AGIM		PETRELA						
									AGRON		BEJA						
									BLEDAR		BEJA						
									ERVIN		KALAJA						
1. Hyrja në zonën ajrore do të jetë e kufizuar, në mënyrë që të parandalohet hyrja e personave dhe automjeteve të paautorizuara.

2. Hyrja në zonat e kufizuara të sigurisë të jetë e kontrolluar, në mënyrë që të garantohet se nuk hyjnë persona apo automjete të paautorizuara.

3. Personave dhe automjeteve mund t'u lejohej hyrja në zonën ajrore ose zonat e kufizuara të sigurisë vetëm nëse përmbushin kushtet e kërkuara të sigurisë.

4. Personat, përfshirë ekuipazhet e fluturimit, të kenë kaluar me sukses kontrollin e pastërtisë së figurës përpara lëshimit të një karte identifikuese aeroporti apo karte identifikuese ekuipazhi, që u mundëson hyrje të pashoqëruar në zonat e kufizuara të sigurisë.

I.3 Kontrolli i personave të tjerë përveç pasagjerëve dhe sendeve të mbajtura

1. Personat e tjerë, përveç pasagjerëve, bashkë me sendet që mbahen prej tyre, do të kontrollohen mbi një bazë rastësore të vazhdueshme kur hyjnë në zonat e kufizuara të sigurisë, në mënyrë që të parandalohet futja e sendeve të ndaluara në këto zona.

2. Të gjithë personat e tjerë, përveç pasagjerëve, bashkë me sendet që mbahen prej tyre, do të kontrollohen kur hyjnë në pjesët kritike të zonave të kufizuara të sigurisë, në mënyrë që të parandalohet futja e sendeve të ndaluara në këto pjesë.

I.4 Kontrolli i automjeteve

Automjetet, që hyjnë në zonat e kufizuara të sigurisë, të kontrollohen në mënyrë që të parandalohet futja e artikujve të ndaluar në këto zona.

I.5 Mbikëqyrja, patrullimi dhe kontrollet e tjera fizike

Në aeroporte dhe, kur është e mundur, në zonat ngjitur me ato publike, të ketë mbikëqyrje, patrullim dhe kontrolle të tjera fizike në mënyrë që të identifikohet sjellja e dyshimtë e personave, dobësitë që mund të shfrytëzohen për të kryer akte të ndërhyrjes së paligjshme dhe për të parandaluar personat që të kryejnë të tilla akte.

II. ZONAT E DEMARKUARA TË AEROPORTEVE

Avionët e parkuar në zonat e demarkuara të aeroporteve, në të cilat aplikohen masat alternative të sigurisë, do të jenë të ndara nga avionët mbi të cilët aplikohen standardet bazë, në mënyrë që të sigurohet se këto standarde të aplikuar për avionët, pasagjerët, bagazhet, kargon dhe postën nuk cenohen.

III. SIGURIA E AVIONIT

1. Përpara nisjes, një avion është subjekt i verifikimit të sigurisë së avionit apo kontrollit të sigurisë së avionit, në mënyrë që të garantohet se nuk ka artikuj të ndaluar në bord të avionit. Një avion tranzit mund të jetë subjekt i të tjera masave të përshtatshme sigurie.

2. Çdo avion do të mbrohet nga ndërhyrja e paautorizuar.

IV. PASAGJERËT DHE BAGAZHET E KABINËS

IV.1 Kontrolli i pasagjerëve dhe bagazheve të kabinës

1. Të gjithë pasagjerët në nisje, transfertë apo tranzit dhe bagazhet e tyre të kabinës të kontrollohen në mënyrë që të parandalohet futja e artikujve të ndaluar në zonat e kufizuara të sigurisë apo në bord të avionit.

2. Pasagjerët transfertë dhe bagazhet e tyre të kabinës mund të përjashtohen nga kontrollet, nëse:

a) ata mbërrijnë nga një shtet anëtar, përveç rasteve kur Komisioni apo shteti anëtar informojnë se këta pasagjerë dhe bagazhet e tyre të kabinës nuk mund të konsiderohen se janë kontrolluar në përputhje me standardet bazë; ose

b) ata mbërrijnë nga një vend i tretë ku standardet e aplikuar të sigurisë janë njohur si



ekuivalente me standardet bazë, në përputhje me legjislacionin përkatës të Bashkimit Evropian.

3. Pasagjerët tranzit dhe bagazhet e tyre të kabinës mund të përjashtohen nga kontrollet e sigurisë, nëse:

a) ata qëndrojnë në bord të avionit; ose

b) ata nuk përzihen me pasagjerët në nisje, përveç atyre që janë në të njëjtin avion;

c) ata mbërrin nga një shtet anëtar të BE-së, përveç rasteve kur Komisioni apo shteti anëtar informojnë se këta pasagjerë dhe bagazhet e tyre të kabinës nuk mund të konsiderohen se janë kontrolluar në përputhje me standardet bazë; ose

ç) ata mbërrin nga një vend i tretë ku standardet e aplikuara të sigurisë janë njohur si ekuivalente me standardet bazë në përputhje me këtë vendim dhe legjislacionin përkatës në fuqi të Bashkimit Evropian.

IV.2 Mbrojtja e pasagjerëve dhe bagazheve të kabinës

1. Pasagjerët dhe bagazhet e kabinës të mbrohen nga ndërhyrja e paautorizuar që nga momenti që ata janë kontrolluar deri në nisjen e avionit në të cilin ndodhen.

2. Pasagjerët e kontrolluar në nisje nuk do të përzihen me pasagjerët në mbërritje, përveç rasteve kur:

a) ata mbërrin nga një shtet anëtar i BE-së dhe Komisioni apo shteti anëtar nuk kanë dhënë informacion se këta pasagjerë dhe bagazhet e tyre të kabinës nuk mund të konsiderohen se janë kontrolluar në përputhje me standardet bazë; ose

b) ata mbërrin nga një vend i tretë ku standardet e aplikuara të sigurisë janë njohur si ekuivalente me standardet bazë, në përputhje me këtë vendim dhe legjislacionin përkatës në fuqi të Bashkimit Evropian.

IV.3 Pasagjerët e mundshëm problematikë

Përpara se të nisen, pasagjerët e mundshëm problematikë do t'u nënshtrohen kontrolleve të përshtatshme të sigurisë.

V. BAGAZHI I HAMBARIT

V.1 Skringu i bagazhit të hambarit

1. Të gjitha bagazhet e hambarit do të kontrollohen përpara se të ngarkohen në avion, me qëllim parandalimin e futjes së artikujve të ndaluar në zonat e kufizuara të sigurisë apo në bord të avionit.

2. Bagazhi i hambarit transfertë mund të përjashtohet nga kontrollet, nëse:

a) mbërrin nga një shtet anëtar i BE-së, përveç rasteve kur Komisioni apo shteti anëtar informojnë se bagazhet e hambarit nuk mund të konsiderohen se janë kontrolluar në përputhje me standardet bazë; ose

b) mbërrin nga një vend i tretë ku standardet e aplikuara të sigurisë janë njohur si ekuivalente me standardet bazë, në përputhje me këtë vendim dhe legjislacionin përkatës në fuqi të Bashkimit Evropian.

3. Bagazhi i hambarit tranzit mund të përjashtohet nga kontrolli nëse qëndron në bord të avionit.

V.2 Mbrojtja e bagazhit të hambarit

Bagazhi i hambarit të mbrohet nga ndërhyrja e paautorizuar që nga momenti që është kontrolluar apo pranuar nga një operator ajror, cilado ndodh më shpejt, deri në nisjen e avionit në të cilin bagazhi ndodhet.

V.3 Pajtueshmëria e bagazhit

1. Çdo bagazh i hambarit të identifikohet nëse është i shoqëruar apo i pashoqëruar.

2. Bagazhet e pashoqëruara nuk do të transportohen, përveç rasteve kur bagazhi është ndarë nga pasagjeri përtej arsyeve që lidhen me pasagjerin apo kur ndaj bagazhit janë kryer kontrollet e duhura të sigurisë.

VI. KARGOJA DHE POSTA

VI.1 Kontrollet e sigurisë për kargon dhe postën

1. Kargoja dhe posta do t'u nënshtrohet kontrolleve të sigurisë përpara se të ngarkohet në avion. Një operator ajror nuk do të pranojë kargo dhe postë për transport në avion, përveç rasteve kur i ka aplikuar kontrollet e sigurisë vetë ose në rastet kur këto kontrolle janë kryer nga një agjent i rregullt, dërgues i njohur apo dërgues përgjegjës.

2. Kargoja dhe posta transfertë mund të jenë subjekt i kontrolleve alternative të sigurisë, të cilat do të detajohen në një akt implementues.

3. Kargoja dhe posta tranzit mund të përjashtohen nga kontrollet e sigurisë nëse qëndrojnë në bord të avionit.

VI.2 Mbrojtja e kargos dhe postës

1. Kargoja dhe posta do të mbrohen nga ndërhyrja e paautorizuar që nga momenti që është kontrolluar deri në nisjen e avionit në të cilin ndodhet.



2. Kargoja dhe posta, që nuk është mbrojtur në mënyrën e duhur, pasi janë kryer kontrollet e sigurisë, do të kontrollohet përsëri.

VII. MATERIALET DHE POSTA E OPERATORIT AJROR

Materialet dhe posta e operatorit ajror do t'u nënshtrohen kontrolleve të sigurisë e më tej të mbrohen deri në ngarkimin në avion të tyre.

VIII. FURNIZIMET NË FLUTURIM

Furnizimet në fluturim, përfshirë kateringun, që kanë për qëllim të transportohen apo të përdoren në bord të avionit, do të jenë subjekt i kontrolleve të sigurisë, e më pas të mbrohen deri sa të ngarkohen në avion, me qëllim parandalimin e futjes së artikujve të rrezikshëm në bord të avionit.

IX. FURNIZIMET E AEROPORTIT

Furnizimet, që kanë për qëllim të shiten apo të përdoren në zonat e kufizuara të sigurisë së aeroportit, duke përfshirë furnizimet për dyqanet *duty-free* dhe restorantet, do t'u nënshtrohen kontrolleve të duhura të sigurisë, për të parandaluar futjen e artikujve të ndaluar në këto zona.

X. MASAT E SIGURISË NË FLUTURIM

1. Pa ndërhyrë në rregullat e sigurisë në operim (*safety*):

a) personave të paautorizuar t'u ndalohet hyrja në ekuipazhin e kabinës gjatë një fluturimi;

b) pasagjerët e mundshëm problematikë t'u nënshtrohen masave të duhura të sigurisë gjatë një fluturimi.

2. Masat e duhura të sigurisë, të tilla si trajnimi i ekuipazhit të kabinës apo ekuipazhit të fluturimit, do të merren me qëllim parandalimin e akteve të ndërhyrjes së paligjshme gjatë një fluturimi.

3. Armët, më përjashtim të atyre që transportohen në hambarin e avionit, nuk do të lejohen në bord të avionit, përveç rasteve kur janë përmbushur kushtet e sigurisë sipas ligjeve kombëtare dhe është dhënë autorizimi nga shtetet përkatëse.

4. Pika 3 do të aplikohet edhe për oficerët e sigurisë në fluturim, nëse ata mbajnë armë.

XI. REKRUTIMI I STAFIT DHE TRAJNIMI

1. Personat, që zbatojnë apo janë përgjegjës për skanimin, kontrollin e hyrjeve dhe kontrollet e tjera të sigurisë, do të rekrutohen, do të trajnohen dhe, kur është e nevojshme, të certifikohen për të garantuar së ata janë të përshtatshëm për t'u punësuar dhe zotërojnë kompetencën e duhur për të kryer detyrat për të cilat janë caktuar.

2. Personat e tjerë, përveç pasagjerëve, të cilët kërkojnë hyrje në zonat e kufizuara të sigurisë, do të kryejnë trajnim sigurie, përpara se t'u lëshohet një kartë identifikuese aeroporti apo një kartë identifikuese ekuipazhi.

3. Trajnimet e përmendura në pikat 1 dhe 2 do të jenë fillestare dhe rifreskuese.

4. Instruktorët e përfshirë në dhënien e trajnimeve të përmendura në pikat 1 dhe 2 do të kenë kualifikimet e nevojshme.

XII. PAJISJET E SIGURISË

Pajisjet e përdorura për skanimin, kontrollin e hyrjeve dhe kontrolleve të tjera të sigurisë të jenë në përputhje me specifikimet e përcaktuara dhe në gjendje për të kryer kontrollet përkatëse të sigurisë.

VENDIM

Nr. 822, datë 24.12.2021

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 465, DATË 26.7.2018, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR KRIJIMIN E TASK-FORCËS PËR PËRMIRËSIMIN E NIVELIT TË KONTROLLIT TË MJETEVE MOTORIKE E RIMORKIOVE TË TYRE", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 88, të ligjit nr. 8308, datë 18.3.1998, "Për transportet rrugore", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Pika 7, e vendimit nr. 465, datë 26.7.2018, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, ndryshohet, si më poshtë vijon:

"7. Periudha e veprimit të Task-Forcës do të jetë deri më 31 dhjetor 2022."

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama



VENDIM
Nr. 825, datë 24.12.2021

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME
NË VENDIMIN NR. 109, DATË 15.2.2017,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR
ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN
E AGJENCISË SË SIGURIMIT TË
CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË E TË
BORDIT TË AKREDITIMIT DHE PËR
PËRCAKTIMIN E TARIFAVE PËR
PROCESET E SIGURIMIT TË CILËSISË
NË ARSIMIN E LARTË”, TË
NDRYSHUAR²**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 14, 15 e 106, të ligjit nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Arsimit dhe Sportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 109, datë 15.2.2017, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

a) Në fund të shkronjës “c”, të pikës 4, shtohen fjalët “..., në funksion të rritjes së cilësisë dhe formatimit, sipas modeleve të aprovuara të tyre.”.

b) Pas shkronjës “c”, të pikës 4, të shtohen shkronjat “ç” dhe “d”, me këtë përmbajtje:

“ç) ndjekjen e proceseve të vlerësimit të jashtëm në kuadër të akreditimit periodik e të monitorimit të vazhduar të cilësisë të institucioneve të arsimit të lartë dhe të programeve të tyre të studimit;

d) organizimin dhe nxjerrjen e rezultateve përfundimtare në kuadër të Sondazhit Kombëtar të Studentëve.”.

c) Pika 7 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“7. Drejtori i Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë emërohet, lirohet/shkarkohet nga detyra me propozimin e ministrit përgjegjës për arsimin, me urdhër të Kryeministrit. Drejtori i Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë duhet të plotësojë kriteret e mëposhtme:

a) të zotërojë të paktën gradën shkencore “Doktor”;

b) të ketë eksperiencë pune mbi 5 (pesë) vjet në institucione që ushtrojnë veprimtari në fushën e arsimit të lartë, duke përfshirë edhe eksperiencë në nivele të larta drejtuese.”.

ç) Në fund të shkronjës “a”, të pikës 12, shtohet paragrafi, me këtë përmbajtje:

“Bëhen pjesë e komisioneve të vlerësimit të jashtëm partnerë nga tregu i punës dhe studentë (anëtar i organeve kolegjiale të IAL-ve), pa të drejtë vote, dhe kanë vetëm rol monitorues.”.

d) Në fund të shkronjës “b”, të pikës 12, shtohet paragrafi, me këtë përmbajtje:

“Përfashtim bëjnë rastet kur në një fushë mungojnë ekspertët dhe duhen angazhuar ekspertë të rinj, që shtojnë listën, por gjithmonë sipas kriterëve dhe në bashkëpunim me Bordin e Akreditimit.”.

dh) Tabela 2/b, e shtojcës 2, bashkëlidhur vendimit, zëvendësohet me tabelën me të njëjtën numër, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Sportit, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë dhe institucionet e arsimit të lartë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

² Ky vendim është përafuar pjesërisht me Rekomandimin e Këshillit të Evropës (2017/C 189/03), datë 22 maj 2017, “Mbi Kornizën Evropiane të Kualifikimeve për të mësuarit gjatë gjithë jetës dhe shfuqizimin e rekomandimit të Parlamentit Evropian dhe Këshillit të 23 prillit 2008, për themelimin e Kornizës Evropiane të Kualifikimeve për të nxënëit gjatë gjithë jetës”.
Faqe | 20596



Tabela 2/b
Tarifat për vlerësimin e jashtëm dhe akreditimin e programeve të studimit

Nr.	Programet e studimit	Tarifa
1	2-vjeçar profesional	173 621
2	Bachelor	225 747
3	Bachelor 4-vjeçar	277 874
4	Master profesional 1 vit	173 621
5	Master profesional 2 vjet	225 747
6	Master i shkencave	364 517
7	Master i shkencave i integruar	600 945
8	Master ekzekutiv 1 vit	308 417
9	Master ekzekutiv 2 vjet	364 517
10	SPA 2 vjet	364 517
11	SPA 3–4 vjet	482 731
12	Doktoratë	610 490

VENDIM
Nr. 826, datë 24.12.2021

**PËR MBULIMIN E SHPENZIMEVE TË
MJEKIMIT TË ZNJ. EGLA LLESHAJ**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr. 137/2020, “Për buxhetin e vitit 2021”, të ndryshuar, dhe në vijim të vendimit nr. 20, datë 20.1.2021, të Këshillit të Ministrave, “Për financimin e shërbimeve shëndetësore spitalore nga skema e detyrueshme e sigurimeve të kujdesit shëndetësor për vitin 2021”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Mbulimin e shpenzimeve të mjekimit të znj. Egla Lleshaj, në masën 1 500 000 (një milion e pesëqind mijë) lekë.

2. Ky fond të përballohet nga Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor.

3. Pagesa të bëhet me paraqitjen e faturave përkatëse të institucionit të kurimit.

4. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

vendim
Nr. 827, datë 24.12.2021

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA
NË VENDIMIN NR. 171, DATË 27.3.2019,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR
MIRATIMIN E RREGULLORES ‘PËR
KUSHTET DHE KRITERET E
USHTRIMIT TË VEPRIMTARISË
SË STACIONIT TË PLAZHIT”,
TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 64, të ligjit nr. 93/2015, “Për turizmin”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Turizmit dhe Mjedisit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në tekstin e rregullores “Për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit”, që i bashkëlidhet vendimit nr. 171, datë 27.3.2019, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Në shkronjën “d”, të nenit 2, emërtimi “Qendra e Formimit Profesional” zëvendësohet me fjalët “... qendrat e formimit profesional ...”.

2. Në pikën 7, të nenit 5, fjalët “... nuk mund të jenë më të vogla se 200 (dyqind) m² dhe më të mëdha se 5 000 (pesë mijë) m².” zëvendësohen me “... nuk mund të jenë më të vogla se 50 (pesëdhjetë) m² dhe më të mëdha se 6 000 (gjashtë mijë) m².”.

3. Në shkronjën “dh”, të nenit 8, fjalët “... qendra e formimit profesional përkatës.”



zëvendësohen me “... qendrat e formimit profesional përkatëse.”.

4. Në nenin 14 bëhen ndryshimi dhe shtesat e mëposhtme:

a) Në pikën 1, fjalët “... për vitin 2021 ...” zëvendësohen me “... për vitin 2022 ...”.

b) Në shkronjën “c”, të pikës 10, bëhen këto shtesa:

i. Në fund të nënndarjes “ii” shtohet fjalia, me këtë përmbajtje:

“Përfundimisht, subjektet, që paraqesin kërkesën për lidhjen e kontratave për ushtrimin e veprimtarisë së stacioneve të plazheve, sipas shkronjës “ç”, të pikës 7, të këtij neni, paraqesin gjenerimin e mandatpagesës të përcaktuar më lart, nëpërmjet portalit *e-Albania*, para nënshkrimit të kontratës.”.

ii. Pas nënndarjes “ii” shtohet nënndarja “ii/1”, me këtë përmbajtje:

“ii/1. Vërtetimin nga autoritetet tatimore se subjekti ka shlyer të gjitha detyrimet tatimore;”.

iii. Në fund të nënndarjes “iii” shtohen fjalët “... si dhe vendimin e Këshillit Kombëtar të Territorit për miratimin e stacioneve të plazhit, vetëm për subjektet që kanë kërkuar lidhjen e kontratave për ushtrimin e veprimtarisë së stacioneve të plazheve, sipas shkronjës “ç”, të pikës 7, të këtij neni.”.

5. Kudo në përmbajtje të tekstit të rregullores, fjala “aplikim” zëvendësohet me “kërkesë”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM

Nr. 828, datë 24.12.2021

PËR MIRATIMIN E DOKUMENTACIONIT SHOQËRUES TË FORMULARIT, AFATEVE DHE PROCEDURËS SË SHQYRTIMIT TË KËRKESËS PËR PAJISJE ME DEKLARATË, SI DHE TË DEKLARATËS PËR ARRITJEN E FAZËS SË ZHVILLIMIT PËRFUNDIMTAR TË KËRKIMIT SHKENCOR PËR BURIMET GJENETIKE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 6, të nenit 49/1, të ligjit nr. 9587, datë 20.7.2006, “Për mbrojtjen e biodiversitetit”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Turizmit dhe Mjedisit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e dokumentacionit shoqërues të formularit, afateve dhe procedurës së shqyrtimit të kërkesës për pajisje me deklaratë të kontrollit të detajuar ndaj kërkitimit shkencor për burimet gjenetike, si dhe të deklaratës për arritjen e fazës së zhvillimit përfundimtar të kërkitimit shkencor, sipas përcaktimeve të këtij vendimi.

2. Dokumentacioni shoqërues i formularit përmban:

a) certifikatën për përdorimin e materialit biologjik të lëshuar nga ministria për kërkesën për akses në burimet gjenetike *in-situ*;

b) dokumentin e miratimit nga ministria për aksesin në burime gjenetike *ex-situ*;

c) marrëveshjen për transferimin e materialit nga burimet *ex-situ*, që janë në pronësi apo financim publik dhe të të dhënave shoqëruese të tyre;

ç) pëlqimin e informuar paraprak me shkrim nga komuniteti, për të pasur akses në dijet, risitë dhe praktikat e komuniteteve vendore, në lidhje me burimet gjenetike e njohuritë tradicionale;

d) miratimin paraprak për transferimin e materialeve gjenetike të të tretët në bazë të normave ndërkombëtare, të lëshuar nga ministria/apo pronari privat, si dhe marrëveshjen e nënshkruar nga palët;

dh) informacionin për materialin biologjik, që do të jetë objekt i shfrytëzimit të burimeve gjenetike,



1.2 Emri shkencor i burimit gjenetik

Emri i zakonshëm i llojit:

1.3 Statusi i llojit

I rrezikuar Endemike I përkeqësuar I kërcënuar

Sasia

Karakteristika							
		Ekzemplarët ¹	Fara, spore organele, embrione	Pjesë Gamete	Qelizat somatike	Acidet nukleike	Pjesë të tjera ²
Faune	vertebrorë						
	jovertebrorë						
Bimë							
Alga							
protozoar							
Kërpudha							
Baktere							
Myshk							
Virus							
Grupime të tjera ³							

¹ Në mungesë të pjesëve të veçanta të një mostre, referojuni qelizës përkatëse si “mostra të plota”. ² Kategoria “pjesë të tjera” përfshin pjesët riprodhuese, strukturat riprodhuese vegetative si kërcell, zhardhokë dhe rizoma. ³ Kategoria “grupime të tjera” përfshin llumin, mykun etj.

SHTOJCA NR. 2

2.1 Informacionin mbi metodat laboratorike për veprimtaritë kërkimore-shkencore në burimet gjenetike

2.2 Baza shkencore: Duhet të paraqitet një përmbledhje e parimeve se si funksionon metoda, p.sh. informacion i bazuar në biologjinë molekulare të ADN-së (p.sh. për PCR në kohë reale). Rekomandohen referenca për publikimet përkatëse shkencore.



2.3 Të paraqitet protokollin i plotë i optimizuar i metodës/metodave të kërkimit shkencor në burimet gjenetike nëse aplikohet në mënyrë të pavarur në laboratorë të tjerë.

Të përshkruhen qartë të gjitha fazat e protokollit operacional.

2.4 Protokollin i punës në laborator, duhet të përfshijë detaje në lidhje me:

Kushtet, udhëzimet dhe rregullat e punës.

Përcaktimi i materialeve të kërkuara, përfshirë një vlerësim të sasive dhe udhëzimeve për ruajtjen dhe trajtimin e materialeve gjenetike.

Pajisjet e kërkuara, qoftë pajisjet kryesore, të tilla si një sistem PCR ose centrifugë, si: instrumente të vogla, si mikropipetat, tubat e reagimit, madhësitë e duhura të tyre etj.

2.5 Të përshkruhet metodika e regjistrimit të të dhënave (programeve biostatistikore).

VENDIM

Nr. 829, datë 24.12.2021

PËR MIRATIMIN E KRITEREVE TË USHTRIMIT DHE TË MONITORIMIT TË VEPRIMTARIVE KËRKIMORE-SHKENCORE NË FONDIN PYJOR KOMBËTAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 4, të nenit 20, të ligjit nr. 57/2020, “Për pyjet”, me propozimin e ministrit të Turizmit dhe Mjedisit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përcaktimin e kriterëve për ushtrimin, miratimin dhe monitorimin e veprimtarive kërkimore-shkencore në Fondin PyJOR Kombëtar, sipas këtij vendimi.

2. Veprimtaritë kërkimore-shkencore në fushën e pyjeve kryhen nga institucione arsimore e shkencore, subjekte fizike e juridike, që përmbushin kushtet dhe kriteret, sipas legjislacionit të posaçëm në fushën kërkimore-shkencore, duke konsideruar edhe respektimin e barazisë gjinore.

3. Kriteret që duhet të përmbushë subjekti, sipas përcaktimit të pikës 2, të këtij vendimi, janë, si më poshtë vijon:

a) Të ketë gradë shkencore në fushën e pyjeve dhe përvojë mbi 10-vjeçare në fushën e pyjeve;

b) Të ketë të paktën 3 specialistë pyjesh me kualifikim jo më të ulët se “Master shkencor” dhe

drejtuesin me gradë shkencore dhe përvojë mbi 10-vjeçare në fushën e pyjeve;

c) Për institucionet arsimore e shkencore dhe subjektet fizike e juridike që kërkojnë të ngrenë baza eksperimentale dhe didaktike në fondin pyJOR publik, drejtuesi i grupit studimor të ketë mbi 10 vjet eksperiencë në fushën e pyjeve;

ç) Të marrë përsipër përgjegjësinë për mbrojtjen e fondit pyJOR në dispozicion gjatë ushtrimit të aktivitetit, nëpërmjet dorëzimit të formularit të plotësuar të vetëdeklarimit.

4. Për miratimin e veprimtarisë kërkimore-shkencore në fondin pyJOR bashkiak, si pjesë e Fondit PyJOR Kombëtar, institucionet arsimore e shkencore dhe/ose subjektet fizike e juridike paraqesin kërkesën me shkrim për miratim pranë bashkisë përkatëse, që ka në pronësi këtë fond.

5. Kërkesa me shkrim shoqërohet me dokumentacionin që vërteton plotësimin e kriterëve të përcaktuara në pikën 3, të këtij vendimi, si dhe me dokumentacionin sipas përcaktimeve në tri shtojcat që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse të tij:

a) Shtojca nr. 1 pasqyron detaje mbi kërkuesin;

b) Shtojca nr. 2 pasqyron detajet mbi veprimtarinë kërkimore-shkencore;

c) Shtojca nr. 3, vetëdeklarimi.

6. Struktura përgjegjëse për pyjet në bashki, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve pune nga data e regjistrimit të kërkesës, shqyrton kërkesën.

7. Në rast se strukturat përgjegjëse për pyjet në bashki konstatojnë se kërkesa e paraqitur nga institucionet arsimore e shkencore dhe/ose



subjektet fizike e juridike nuk është në përputhje me përcaktimin e pikës 5 të këtij vendimi, atyre u kërkohet plotësimi i dokumentacionit brenda 7 (shtatë) ditëve nga dita e regjistrimit të kërkesës. Në rast se subjekti nuk paraqet dokumentacionin plotësues brenda afatit të caktuar, kërkesa quhet se nuk është regjistruar dhe i kthehet kërkuarit me të gjitha aktet e tjera të depozituara.

8. Struktura përgjegjëse për pyjet në bashki mbështetet në planet e mbarëshkëlqimit për shqyrtimin e kërkesës së subjektit, për ushtrimin e veprimtarisë kërkimore-shkencore dhe, në rast se kërkesa është në përputhje me përcaktimet e legjislacionit në fuqi për pyjet, si dhe parashikimet e këtij vendimi, miraton të drejtën e ushtrimit të veprimtarisë kërkimore-shkencore. Çdo kërkesë e miratuar regjistrohet dhe i përcillet informacioni, në fund të çdo viti apo kur i kërkohet, Agjencisë Kombëtare të Pyjeve dhe ministrisë përgjegjëse për pyjet.

9. Monitorimi i veprimtarisë kërkimore-shkencore nga struktura përgjegjëse për pyjet në bashki dhe Agjencia Kombëtare e Pyjeve realizohet në bazë të kriterëve të mëposhtme:

a) pasojat në ekosistemin pyjor nga realizimi i veprimtarisë kërkimore-shkencore;

b) ndikimi në grumbullin pyjor apo popullatën e faunës;

c) dëmtimi i individëve apo popullatave të florës dhe faunës;

ç) përdorimi i burimeve natyrore, i cili të jetë në përputhje me kushtet e miratimit të kërkimit shkencor të miratuar;

d) dorëzimi i raportit përmbledhës në fund të aktivitetit.

10. Në rastet e studimeve, marrjes dhe programeve të tjera lidhur me përdorimin e bazës gjenetike të florës/faunës, bashkia për dhënien e miratimit për ushtrimin e veprimtarisë së kërkimit shkencor në Fondin Pyjor Kombëtar dhe subjekti që ushtron këtë veprimtari duhet të bazohen në kërkesat e ligjit nr. 9587, datë 20.7.2006, “Për mbrojtjen e biodiversitetit”, të ndryshuar.

11. Në rast se kërkesa për ushtrimin e veprimtarisë kërkimore-shkencore bëhet për pyjet në pronësi private, institucionet arsimore e shkencore, subjektet fizike e juridike i paraqesin kërkesën pronarit si edhe bashkisë brenda territorit të së cilës gjendet sipërfaqja pyjore. Kërkesa miratohet nga bashkia përkatëse, bazuar në parashikimet e këtij vendimi, pas marrjes së dakordësisë nga pronari.

12. Kur veprimtaria kërkimore-shkencore kërkohet në Fondin Pyjor të Zonave të Mbrojtura Mjedisore, zbatohen përcaktimet e bëra në vendimin nr. 302, datë 10.5.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për kriteret e ushtrimit, të miratimit e monitorimit të veprimtarive kërkimore-shkencore në zonat e mbrojtura mjedisore”.

13. Ngarkohen Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, bashkitë dhe Agjencia Kombëtare e Pyjeve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

SHTOJCA NR. 1
FORMULARI I APLIKIMIT**KËRKESE
PËR TË DREJTËN E USHTRIMIT TË VEPRIMTARIVE
KËRKIMORE-SHKENCORE
NË FONDIN PYJOR KOMBËTAR**

DETAJE TË APLIKUESIT/APLIKUESVE (zgjidh opsionin)

1.1 Emër Mbiemër:	1.1.1 Pozicioni:
1.2 Institucioni (emërtimi dhe NIPT):	
1.3 Adresa:	1.3.1 Kodi postar:
1.4 Nr. i telefonit/ <i>e-mail</i> :	
1.5 Lista e anëtarëve të stafit pjesëmarrës në studimin kërkimor-shkencor, grada shkencore, pozicioni:	
1.6 Titulli i studimit/projektit:	
1.7 Bashkia:	
1.8 Ekonomia pyjore dhe ngastra në të cilën zhvillohet veprimtaria (me treguesit kadastralë):	
1.9 Koordinatat gjeografike të zonës (KRRGJSH):	
1.10 Përshkrimi i shkurtër i projektit:	
1.10.1 Metodologjia e studimit/projektit:	
1.10.2 Fillimi dhe mbarimi i projektit:	
1.10.3. Data e dorëzimit të raportit përfundimtar:	

MBAR



SHTOJCA NR. 2
DETAJE MBI VEPRIMTARINË KËRKIMORE-SHKENCORE NË FONDIN PYJOR KOMBËTAR

Bashkia	Treguesit kadastralë të zonës që do të studiohet	Emri i llojit florë/faunë (latinisht)	Emri i zakonshëm i llojit florë/faunë (shqip)	Gjendja e objektit të studimit/kërkimit	Statusi i llojit/ve	Sasia	Shpeshtësia e matjeve dhe marrjes së mostrave/provave
				<input type="checkbox"/> I gjallë <input type="checkbox"/> I ngordhur <input type="checkbox"/> Material gjenetik <input type="checkbox"/> Mostra	<input type="checkbox"/> I rrezikuar <input type="checkbox"/> I përkeqësuar <input type="checkbox"/> I kërcënuar		



SHTOJCA NR. 3

VETËDEKLARIM

Unë i/e nënshkruari/a _____ i/e datëlindjes _____
(emër/atësi/mbiemër) (datë/muaj/vit)

Nëse aplikanti përfaqëson një institucion duhet të saktësojë pozicionin që mban

1. Deklaroj, me vullnet të lirë e të plotë, se mbaj përgjegjësi personale për të gjithë informacionin që është plotësuar në këtë formular dhe se veprimtaria e kërkimit shkencor nuk do të ketë ndikime negative në drejtim të prishjes së ekuilibrave natyrorë dhe se pas përfundimit të projektit do të dorëzojë pranë bashkisë dhe Agjencisë Kombëtare të Pyjeve raportin përmbledhës për rezultatet e arritura gjatë kryerjes së kësaj veprimtarie në fondin pyjor.

Deklaruesi Datë

Firma

VENDIM
Nr. 830, datë 24.12.2021

**PËR MASAT LIDHUR ME SIGURIMIN E
INFORMACIONIT PËR KONSUMIN E
LËNDËS DJEGËSE DHE SHKARKIMET
E CO₂ GJATË MARKETINGUT TË
AUTOMJETEVE TË REJA³**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 4, të nenit 13, të ligjit nr. 155/2020, “Për ndryshimet klimatike”, dhe të shkronjës “c”, të nenit 14, të ligjit nr. 162/2014, “Për mbrojtjen e cilësisë së ajrit në mjedis”, me propozimin e ministrit të Turizmit dhe Mjedisit dhe të ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përcaktimin e masave për sigurimin e informacionit për konsumin e lëndës djegëse dhe shkarkimet e CO₂ nga autoveturat e reja, të cilat

³ Ky projektvendim transponon pjesërisht direktivën 1999/94/EC të Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, e 13 dhjetorit 1999, në lidhje me disponueshmërinë e informacionit të konsumatorit për konsumin e lëndës djegëse dhe shkarkimet e CO₂, në lidhje me tregtimin e automjeteve të reja të pasagjerëve, të ndryshuar.

ofrohen për shitje ose për dhënie me qira në Republikën e Shqipërisë. Ky informacion u vihet në dispozicion konsumatorëve, me qëllim:

- a) që t'u mundësojë atyre të bëjnë një zgjedhje të bazuar në informacion;
- b) promovimin e blerjes ose të dhënies me qira të autoveturave, që përdorin më pak lëndë djegëse dhe, në këtë mënyrë, shkarkojnë më pak CO₂ në mjedis.

2. Për qëllime të këtij vendimi, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

- a) **“Autoveturë për pasagjerë”**, i njëjti kuptim sipas përcaktimit në shkronjën “a”, të pikës 1, të nenit 54, të ligjit nr. 8378, datë 22.7.1998, “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar;
- b) **“Autoveturat e reja për pasagjerë”**, çdo autoveturë, e cila nuk i është shitur më parë, përveçse për qëllim shitjeje në pakicë apo shpërndarjeje për shitje;
- c) **“Certifikata e përputhshmërisë”**, certifikata e përputhshmërisë të lëshuar nga prodhuesi;
- ç) **“Etiketa për konsumin e lëndës djegëse dhe shkarkimet e CO₂/Fuel economy label”** (në vijim “etiketa”), etiketa, që përmban informacionin për konsumatorin për konsumin zyrtar të lëndës djegëse dhe shkarkimet specifike



zyrtare të CO₂, për autoveturën ku është bashkëngjitur etiketa;

d) **“Konsum zyrtar i lëndës djegëse”**, konsumi i lëndës djegëse, siç përcaktohet në udhërrëfyesin për konsumin e lëndës djegëse të autoveturave të reja për pasagjerë, në certifikatën e përputhshmërisë të lëshuar nga prodhuesi ose në certifikatën e miratimit të tipit të autoveturës. Kur disa variante dhe/ose versione grupohen në një model, vlera që duhet dhënë për konsumin e lëndës djegëse të atij modeli bazohet në variantin dhe/ose versionin me konsumin më të lartë zyrtar të lëndës djegëse brenda atij grupi;

dh) **“Literaturë promovuese”**, i gjithë materiali i shtypur që përdoret në marketing për reklamimin e promovimin e autoveturave për publikun e gjerë. Këtu përfshihen, të paktën, udhërrëfyes teknikë, broshura, reklama në gazeta, revista dhe shtypi i specializuar dhe postera;

e) **“Udhërrëfyes për konsumin e lëndës djegëse”**, përmbledhja e të dhënave zyrtare të konsumit të lëndës djegëse dhe të shkarkimeve zyrtare specifike të CO₂, për secilin model të autoveturave të reja, që është i disponueshëm në tregun vendës, sipas certifikatës së përputhshmërisë të lëshuar nga prodhuesi ose certifikatës për miratimin e tipit të autoveturës;

ë) **“Marka”**, emri tregtar i prodhuesit që paraqitet në certifikatën e përputhshmërisë dhe në dokumentacionin e miratimit të tipit;

f) **“Media e ruajtjes elektronike, magnetike ose optike”**, çdo material fizik, për të cilin informacioni mund të regjistrohet në mënyrë elektronike dhe që mund të shërbejë si mjet informacioni për publikun e gjerë;

g) **“Model”**, përshkrimi tregtar i markës, tipit dhe, nëse është i disponueshëm e i përshtatshëm, varianti dhe versioni i një autoveture pasagjerësh;

gj) **“Pikë shitjeje”**, vendndodhja, që mund të jetë një sallë ekspozite/*showroom* autoveturash ose ambient i hapur, ku autoveturat e reja të pasagjerëve shfaqen, ofrohen për shitje, me qira për klientët e mundshëm apo edhe panairët tregtare, ku autoveturat e reja të pasagjerëve paraqiten për publikun;

h) **“Shkarkimet specifike zyrtare të CO₂”**, për një autoveturë të caktuar pasagjerësh, informacioni, që jepet në udhërrëfyesin për konsumin e lëndës djegëse të autoveturave të reja për pasagjerë apo në certifikatën e përputhshmërisë

së lëshuar nga prodhuesi ose në certifikatën e miratimit të tipit të autoveturës. Kur disa variante dhe/ose versione janë grupuar në një model, vlerat që do të jepen për CO₂ të atij modeli do të bazohen në variantin dhe/ose versionin me shkarkimet më të larta zyrtare të CO₂ brenda atij grupi;

i) **“Shitës i autoveturave të reja të pasagjerëve”** (në vijim “shitësi”), personi që shet ose jep me qira autoveturat e reja të pasagjerëve të përdoruesi përfundimtar;

j) **“Shpërndarje me mjete elektronike”**, dërgimi i informacionit dhe marrja në destinacionin e tij me anë të pajisjeve elektronike për përpunim (përfshirë kompresimin digjital) dhe ruajtjen e të dhënave dhe transmetimin e plotë, të transmetuara e të marra me tel, me radio, me anë të mënyrave optike ose mjeteve të tjera elektromagnetike;

k) **“Tip”, “variant” dhe “version”**, autoveturat e diferencuara të një marke të caktuar, që deklarohen nga prodhuesi, sipas përcaktimit në certifikatën e përputhshmërisë, të lëshuar nga prodhuesi e të identifikuar në mënyrë unike, sipas tipit, variantit e karaktereve të versionit alfanumerik;

l) **“Tregtar i autoveturave të reja të pasagjerëve”** (në vijim “tregtari”), prodhuesi, përfaqësuesi i tij i autorizuar, i vendosur në Republikën e Shqipërisë ose person tjetër fizik ose juridik, që importon dhe/ose vendos në treg autoveturat e pasagjerëve në Republikën e Shqipërisë.

3. Çdo tregtar/shitës, që shet ose jep me qira autovetura të reja për pasagjerë, është i detyruar të marrë masat për informimin e konsumatorëve lidhur me:

a) konsumin e lëndës djegëse dhe shkarkimet e CO₂ për modelet e autoveturave që janë në shitje;

b) përmbajtjen e udhërrëfyesit, i cili përgatitet në përputhje me pikën 7 të këtij vendimi.

4. Tregtari siguron që:

a) të dhënat sipas pikës 3 t’u prezantohen konsumatorëve në mënyrë të qartë e të dukshme në çdo vend, ku autoveturat e reja janë të ekspozuara për qëllime promovuese. Të dhënat të jenë të vërteta, të sakta dhe të qarta, sipas informacionit të pasqyruar në etiketën, udhërrëfyesin, posterat, literaturën dhe materialet promovuese, reklama, që shoqërojnë autoveturën e re;



b) të dhënat e prezantuara të mos kenë shenja, simbole ose mbishkrime, në lidhje me konsumin e lëndës djegëse ose shkarkimet e CO₂, që nuk janë në përputhje me kërkesat e këtij vendimi, si dhe të mos shkaktojnë konfuzion për konsumatorin e mundshëm të autovegurave të reja;

c) dokumentacioni promovues për shitjen e autovegurave të reja të orientojë konsumatorët në vendimmarrjen e tyre të blerjes në pikën e shitjes, për modelin e autovegurave të reja, i cili gjendet në atë pikë shitjeje e që përdor më pak lëndë djegëse dhe, për pasojë, shkarkon më pak CO₂ në mjedis.

5. Dokumentacioni promovues për konsumin e lëndës djegëse dhe shkarkimet e CO₂, për çdo model të ri autovegure në shitje, përfshin:

a) etiketën për konsumin e lëndës djegëse dhe shkarkimet e CO₂;

b) udhërrëfyesin për konsumin e lëndës djegëse dhe shkarkimet e CO₂;

c) afishimin/posterin për shitjen e autovegurave të reja;

d) literatura promovuese.

6. Etiketa të jetë në gjuhën shqipe e në përputhje me kërkesat e përcaktuara në shtojcën I, që i bashkëlidhet këtij vendimi. Etiketa vendoset ose shfaqet në mënyrë të qartë e të dukshme, pranë çdo modeli të ri autovegure në pikën e shitjes.

7. Udhërrëfyesi për konsumin e lëndës djegëse dhe shkarkimet e CO₂ përgatitet nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor (DPSHTRR), në konsultim me tregtarin në çdo vit, në përputhje me kërkesat e shtojcës II, që i bashkëlidhet këtij vendimi. Udhërrëfyesi të jetë në version *hard copy*, si edhe në versionin elektronik. Versioni *hard copy* i shtypur në letër të jetë i transportueshëm, i mbledhur dhe falas për konsumatorët.

8. Afishimi/posteri për shitjen e autovegurave përmban të dhënat zyrtare lidhur me konsumin e lëndës djegëse dhe shkarkimet e CO₂ për të gjitha modelet e reja të autovegurave të reja, që prezantohen ose ofrohen për shitje apo qira në ose nëpërmjet asaj pike shitjeje. Të dhënat shfaqen në një pozicion të dukshëm dhe në përputhje me

formatin e kërkesave të shtojcës III, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

9. Tregtari siguron që literaturat promovuese për secilin model të autovegurave të reja, të cilat ofrohen për shitje, përmbajnë të dhëna për konsumin zyrtar të lëndës djegëse e për shkarkimet specifike zyrtare të CO₂, në përputhje me kërkesat e shtojcës IV, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

10. Tregtari siguron që literatura promovuese të ndryshme nga ato në pikën 9, të këtij vendimi, për secilin model të autovegurave të reja që ofrohen për shitje, të përmbajë të dhëna për konsumin zyrtar të lëndës djegëse dhe për shkarkimet specifike zyrtare të CO₂.

11. Shitësi siguron që:

a) të marrë etiketën e çdo modeli të ri autovegure nga tregtari, në përputhje me pikën 6, të këtij vendimi;

b) të vërë në dispozicion etiketën falas për konsumatorët në pikën e shitjes;

c) të disponojë të paktën 50 (pesëdhjetë) kopje të literaturave promovuese dhe 50 copë udhërrëfyesish nga tregtari;

ç) të vërë në dispozicion botimin e fundit të udhërrëfyesit falas për konsumatorët në pikën e shitjes;

d) udhërrëfyesi për konsumin e lëndës djegëse dhe shkarkimet e CO₂ për modelet e autovegurave të reja vihet në dispozicion të konsumatorëve jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga data e botimit të tij.

12. Autoritetet përgjegjëse për monitorimin dhe zbatimin e kërkesave të këtij vendimi janë:

a) struktura përgjegjëse për mbikëqyrjen e tregut pranë ministrisë përgjegjëse për tregtinë dhe mbrojtjen e konsumatorit;

b) Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor (DPSHTRR) pranë ministrisë përgjegjëse për fushën e transportit.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i fillon efektet nga data 1.1.2023.

KRYEMINISTËR
Edi Rama



SHTOJCA I
ETIKETA PËR KONSUMIN E LËNDËS DJEGËSE
DHE SHKARKIMET E CO₂

Të paktën, të gjitha etiketat e konsumit të lëndës djegëse dhe shkarkimet e CO₂ në territorin e Republikës së Shqipërisë:

1. I përmbahen një formati të standardizuar, në mënyrë që të njihen më mirë nga konsumatorët/ të interesuarit;

2. Janë në një madhësi prej 297 mm × 210 mm (A4);

3. Përmbajnë një referencë të modelit dhe të llojit të lëndës djegëse të autoveurave, të cilës i janë bashkëngjitur;

4. Përmbajnë vlerën numerike të konsumit zyrtar të lëndës djegëse dhe shkarkimeve zyrtare specifike të CO₂. Vlera e konsumit zyrtar të lëndës djegëse shprehet në litra për 100 kilometra (l/100 km), ose një kombinim i përshtatshëm i tyre dhe shprehet deri me një numër pas presjes dhjetore. Shkarkimet specifike zyrtare të CO₂ jepen në gram për kilometër (g/km), të rrumbullakosura në numrin e plotë më të përafërt;

5. Përmbajnë tekstin vijues, në lidhje me disponueshmërinë e udhërrëfyesit për konsumin e lëndës djegëse dhe shkarkimet e CO₂: “Një udhërrëfyes mbi konsumin e lëndës djegëse dhe shkarkimet e CO₂, i cili përmban të dhëna për të gjitha modelet e reja të autoveurave, është i disponueshëm falas në çdo pikë shitje”;

6. Përmban tekstin si vijon: “Përveç eficiencës së lëndës djegëse të një autoveure, mënyra e drejtimit të autoveurës, si dhe faktorët e tjerë joteknikë, luajnë rol në përcaktimin e konsumit të lëndës djegëse dhe shkarkimet e CO₂ të një autoveure. CO₂ është gazi kryesor me efekt serrë, përgjegjës për ngrohjen globale”;

7. Etiketa rekomandohet të përmbajë dhe një model të koduar me ngjyra, të ngjashëm me atë të etiketës së energjisë, me shkronja A-G, bazuar në shkarkime të ulëta dhe të larta;

Një prezantim grafik i etiketës mbi konsumin e lëndës djegëse dhe shkarkimet e CO₂, jepet më poshtë:

Prodhuesi:
Marka:
Tipi, varianti, versioni:
Lloji i lëndës djegëse:
Konsumi i lëndës djegëse: XX, X l/100 km ose XX, X m³/100 km
Urban/qytetës:
Extra-urban/interurban/ndërqytetës:
Përbërja:
Shkarkimet e CO₂: XXX g/km
Një udhërrëfyes mbi konsumin e lëndës djegëse dhe shkarkimet e CO ₂ , i cili përmban të dhëna për të gjitha modelet e reja të autoveurave, është i disponueshëm falas në çdo pikë shitje. Përveç eficiencës së lëndës djegëse të një autoveure, mënyra e drejtimit të autoveurës, si dhe faktorët e tjerë joteknikë, luajnë rol në përcaktimin e konsumit të lëndës djegëse të një autoveure dhe në shkarkimet e CO₂, që është gazi kryesor me efekt serrë, përgjegjës për ngrohjen globale.



SHTOJCA II
UDHËRRËFYESI MBI KONSUMIN E LËNDËS DJEGËSE
DHE SHKARKIMET E CO₂

Udhërrëfyesi mbi konsumin e lëndës djegëse dhe shkarkimet e CO₂, përmban të paktën informacionin e mëposhtëm:

1. Një listë për të gjitha modelet e reja të autovecurave, të disponueshme për blerje në Shqipëri mbi baza vjetore, të grupuara sipas markave në rend alfabetik. Nëse udhërrëfyesi përditësohet më shumë se një herë në vit, të përmbajë një listë për të gjitha modelet e reja të autovecurave, të disponueshme në datën e botimit të këtij përditësimi;

2. Për çdo model që shfaqet në udhërrëfyes, jepet informacion mbi llojin e lëndës djegëse, vlerën numerike të konsumit zyrtar të lëndës djegëse dhe shkarkimet specifike zyrtare të CO₂. Vlera e konsumit zyrtar të lëndës djegëse shprehet, në litra për 100 kilometra (l/100 km), në kilometra për litër (km/l), ose një kombinim i përshtatshëm midis tyre dhe pasqyrohet deri në një numër pas presjes dhjetore. Shkarkimet specifike zyrtare të CO₂ shprehen të rrumbullakosura në numrin e plotë më të afërt në gram për kilometër (g/km);

3. Një listë për 10 modelet e autovecurave, me eficiencën më të lartë të lëndës djegëse, të renditura në rend rritës për shkarkimet specifike të CO₂ për secilin lloj të lëndës djegëse. Lista të përmbajë modelin, vlerën numerike të konsumit zyrtar të lëndës djegëse dhe shkarkimet specifike zyrtare të CO₂;

4. Këshilla për drejtuesit e autovecurave, se përdorimi i saktë dhe mirëmbajtja e rregullt e autovecurave, si dhe mënyra e drejtimit, të tilla si: shmangia e drejtimit agresiv, udhëtimi me shpejtësi më të ulët, frenimi paraprak, fryrja e gomave në mënyrën e duhur, reduktimi i kohës së qëndrimit me motorin ndezur dhe shmangia e mbingarkesës, zvogëlojnë konsumin e lëndës djegëse dhe ulin shkarkimet e CO₂ nga autovecurat e tyre për pasagjer;

5. Një shpjegim mbi efektet e shkarkimeve të gazeve me efekt serrë, ndryshimet e mundshme klimatike dhe si ndikojnë autovecurat, si dhe një referencë mbi lëndët e ndryshme djegëse, që janë në dispozicion të konsumatorit dhe ndikimet e tyre në mjedis, bazuar në provat më të fundit shkencore dhe kërkesat ligjore.

Tabela me të dhënat që do përfshihen në udhërrëfyesin mbi konsumin e lëndës djegëse dhe shkarkimet e CO₂.

Tipi dhe modeli i autovecurës	Lloji i lëndës djegëse	WLTP vlerat e konsumit zyrtar të lëndës djegëse (të kombinuara) (l/100 km ose m ³ /100 km ose kwh/100 km bazuar në llojin e lëndës djegëse)	Shkarkimet e CO ₂ (g/km)



SHTOJCA III AFISHIMI/POSTERI QË SHFAQET NË PIKËN E SHITJES

Për qëllime të këtij vendimi, afishimi/posteri të plotësojë të paktën kërkesat, si më poshtë vijon:

1. Afishimi ose posterit të ketë një madhësi minimale/të paktën prej 70 cm × 50 cm;
2. Informacioni të jetë lehtësisht i lexueshëm;
3. Kur informacioni jepet në një ekran elektronik, përmasat e ekranit të jenë të paktën 25 cm × 32 cm (17 inç). Informacioni mund të shfaqet duke përdorur teknikat e rrëshqitjes (*scroll*);
4. Modelet e autovecurave për pasagjer grupohen dhe renditen të ndara sipas llojit të lëndës djegëse që përdor (p.sh. benzinë ose naftë.). Për çdo lloj lënde djegëse/karburanti, modelet renditen në rend rritës për shkarkimet e CO₂ dhe modeli me konsumin më të ulët zyrtar të lëndës djegëse vendoset në krye të listës;
5. Për çdo model autovecure për pasagjer të listuar jepet marka, vlera numerike e konsumit zyrtar të lëndës djegëse dhe shkarkimet specifike zyrtare të CO₂. Vlera e konsumit zyrtar të lëndës djegëse shprehet në litra për 100 kilometra (l/100 km), kilometra për litër (km/l), ose një kombinim i përshtatshëm midis tyre dhe pasqyrohet deri në një numër pas presjes dhjetore. Shkarkimet specifike zyrtare të CO₂ shprehen të rrumbullakosura në numrin më të afërt të plotë në gram për kilometër (g/km);
6. Afishimi/posteri përmban tekstin e mëposhtëm, në lidhje me disponueshmërinë e udhërrëfyesit mbi konsumin e lëndës djegëse dhe shkarkimet e CO₂: “Një udhërrëfyes mbi konsumin e lëndës djegëse dhe shkarkimet e CO₂, i cili përmban të dhëna për të gjitha modelet e autovecurave të reja, është i disponueshëm falas në çdo pikë shitje”. Në rastin e një afishimi/posteri elektronik, ky mesazh të jetë gjithmonë i paraqitur;
7. Afishimi/posteri përmban tekstin në vijim: “Përveç eficiencës së lëndës djegëse të një autovecure, mënyra e drejtimit të autovecures, si dhe faktorë të tjerë joteknikë, luajnë rol në përcaktimin e konsumit të lëndës djegëse dhe shkarkimet e CO₂ të një autovecure. CO₂ është gaz kryesor me efekt serrë, përgjegjës për ngrohjen globale”. Në rastin e një ekrani elektronik, ky mesazh të jetë gjithmonë i paraqitur;
8. Afishimi/posteri përditësohet të paktën çdo gjashtë muaj. Kur përdoret një ekran elektronik, informacioni përditësohet të paktën çdo tre muaj;
9. Afishimi/posteri mund të zëvendësohet plotësisht dhe përgjithmonë nga një ekran elektronik. Në këtë rast, ekrani elektronik do të paraqitet në mënyrë të tillë, që të tërheqë vëmendjen dhe të ndërgjegjësojë konsumatorin të paktën me të njëjtin intensitet, siç do të kishte arritur një afishim/poster.

Një format i posterit, jepet më poshtë:

Lloji i lëndës djegëse	Renditja	Modeli	Shkarkimet zyrtare specifike të CO ₂ (g/km)	Konsumi zyrtar i lëndës djegëse (l/100km ose m ³ /100km)
Benzinë	1.			
	2.			
	...			
Naftë	1.			
	2.			



	...			
Biodiesel	1.			
	2.			
	...			
Gaz i lëngshëm (LPG)	1.			
	2.			
	...			
Gaz natyror i kompresuar (CNG)	1.			
	2.			
	...			
Sistemet hibride	1.			
	2.			
	...			
...	1.			
	2.			
	...			

SHTOJCA IV
SIGURIMI I TË DHËNAVE MBI KONSUMIN E LËNDËS DJEGËSE DHE
SHKARKIMET E CO₂ NË LITERATURA PROMOVUESE

Të gjitha literaturat promovuese të përmbajnë konsumin zyrtar të lëndës djegëse dhe të dhënat zyrtare specifike të shkarkimeve të CO₂ për autoveturat, të cilave u referohen. Ky informacion të plotësojë të paktën kërkesat, si më poshtë vijon:

1. Të jetë lehtësisht i lexueshëm dhe jo më pak i rëndësishëm se pjesa kryesore e informacionit e dhënë në literaturën promovuese;

2. Të jetë lehtësisht i kuptueshëm edhe me një lexim të shpejtë;

3. Të dhënat e konsumit zyrtar të lëndës djegëse të sigurohen për të gjitha modelet e ndryshme të autoveturave që mbulon materiali promovues. Nëse specifikohet më shumë se një model, atëherë të përfshihen të dhënat zyrtare të konsumit të lëndës djegëse për të gjitha modelet e specifikuar, ose të përcaktohet diapazoni midis konsumit më të keq (më të lartë) dhe më të mirë (më të ulët) të lëndës djegëse. Konsumi i lëndës djegëse të shprehet në litra për 100 kilometra (l/100 km), kilometra për litër (km/l), ose një kombinim i përshtatshëm midis tyre. Të gjitha të dhënat numerike shprehen deri në një numër pas presjes dhjetore.

Nëse literatura promovuese përmban vetëm referencën e markës së autoveturës, e jo të ndonjë modeli në veçanti, atëherë të dhënat për konsumin e lëndës djegëse nuk është e nevojshme të jenë të pasqyruara.



VENDIM
Nr.831, datë 24.12.2021

**PËR RISHPËRNDARJE FONDESH NË
BUXHETIN E VITIT 2021, MIRATUAR
PËR MINISTRINË E KULTURËS DHE
PËR QENDRËN KOMBËTARE TË
KINEMATOGRAFISË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 44, të ligjit nr.9936/2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Kulturës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Qendrës Kombëtare të Kinematografisë, në buxhetin e miratuar për vitin 2021, t’i shtohet fondi prej 13 600 000 (trembëdhjetë milionë e gjashtëqind mijë) lekësh, në formën e grantit për Akademinë e Filmit dhe Multimedias “Marubi”, për mbështetjen e veprimtarive krijuese.

2. Efekti financiar sipas pikës 1, të këtij vendimi, në masën 13 600 000 (trembëdhjetë milionë e gjashtëqind mijë) lekë, përballohet nga buxheti i Ministrisë së Kulturës, i miratuar për vitin 2021, në artikullin 604 “Transferata të brendshme”, të programit “Arti dhe kultura”.

3. Ngarkohen Ministria e Kulturës dhe Qendra Kombëtare e Kinematografisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM
Nr. 832, datë 24.12.2021

**PËR RISHPËRNDARJE FONDESH NË
BUXHETIN E VITIT 2021, MIRATUAR
PËR MINISTRINË E KULTURËS DHE
PËR QENDRËN KOMBËTARE TË
KINEMATOGRAFISË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 44, të ligjit nr. 9936/2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e

Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Kulturës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Qendrës Kombëtare të Kinematografisë, në buxhetin e miratuar për vitin 2021, t’i shtohet fondi prej 13 600 000 (trembëdhjetë milionë e gjashtëqind mijë) lekësh, në formën e grantit për Akademinë e Filmit dhe Multimedias “Marubi”, për mbështetjen e veprimtarive krijuese.

2. Efekti financiar sipas pikës 1, të këtij vendimi, në masën 13 600 000 (trembëdhjetë milionë e gjashtëqind mijë) lekë, përballohet nga buxheti i Ministrisë së Kulturës, i miratuar për vitin 2021, në artikullin 604 “Transferata të brendshme”, të programit “Arti dhe kultura”.

3. Ngarkohen Ministria e Kulturës dhe Qendra Kombëtare e Kinematografisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

**PLANI PËR RUAJTJEN, MBROJTJEN DHE
ADMINISTRIMIN E “QENDRËS
HISTORIKE” TË FSHATIT BËNJË DHE TË
ZONËS MBROJTËSE TË SAJ**

Neni 1

Qëllimi dhe objektivat

Ky plan ka për qëllim miratimin e rregullave, të procedurave, të autoriteteve shtetërore përgjegjëse për ruajtjen, mbrojtjen dhe administrimin e “qendrës historike” të fshatit Bënjë dhe zonës mbrojtëse përreth saj.

Neni 2

Objekti

Objekti kryesor të këtij plani janë:

a) ruajtja dhe mbrojtja e vlerave të trashëgimisë kulturore, historike, urbanistike, arkitektonike dhe të peizazhit të “qendrës historike” të fshatit Bënjë dhe zonës mbrojtëse të saj, sipas hartës së zonifikimit bashkëlidhur;



b) administrimi i “qendrës historike” të fshatit Bënjë dhe zonës mbrojtëse të saj;

c) mënyrat e bashkëpunimit të institucioneve të ngarkuara për ruajtjen dhe miradministrimin e vlerave të trashëgimisë kulturore të fshatit Bënjë, me njësitë e vetëqeverisjes vendore.

Neni 3

Hapësira urbane në mbrojtje

1. Hapësira në mbrojtje e fshatit Bënjë përbëhet nga:

- a) “qendra historike”;
- b) zona mbrojtëse.

2. Brenda zonave të përcaktuara në pikën 1, të këtij neni, përfshihen zona e banuar e fshatit, pasuri kulturore të paluajtshme, zona të gjelbra, sheshe dhe objekte pa status, sipas përcaktimeve në ligjin nr. 27/2018, “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”.

3. Plani i përgjithshëm vendor i Bashkisë Përmet merr parasysh kufijtë e zonifikimit të “qendrës historike”, të zonës mbrojtëse të saj, si dhe rregullat për ruajtjen, mbrojtjen e administrimin e tyre.

4. Organet e njëjësive të vetëqeverisjes vendore, në bashkëpunim me institucionet shtetërore të specializuara, sigurojnë ruajtjen dhe mbrojtjen e “qendrës historike”, të zonës mbrojtëse të saj dhe të monumenteve të kulturës, të ngritura në hapësirat e juridiksionit të tyre.

Neni 4

“Qendra historike” dhe kufijtë e saj

1. “Qendra historike” e fshatit Bënjë është hapësira me vlera të rëndësishme të trashëgimisë kulturore, historike, urbanistike, arkitektonike dhe të peizazhit, në të cilat dokumentohen rruga e zhvillimit historik të fshatit drejt krijimit të një qendre të banuar dhe tiparet urbanistiko-arkitekturore, që u formuan gjatë historisë së tij. Pjesa dërrmuese e fshatit ruan rrethim rrugor karakteristik dhe ndërtime të vjetra, me vlera arkitektonike e konstruktive. Këto ndërtime janë të lidhura me mjedisin tradicional, i cili është pjesë e “qendrës historike”.

2. Në “qendrën historike” ndodhen pasuri kulturore të paluajtshme si monumente kulture të

kategoriës I, si kisha e Shën Mërisë, të kategoriës II dhe objekte pa status.

3. Kufijtë e “qendrës historike” paraqiten në hartën e zonifikimit, e cila është pjesë përbërëse e këtij plani.

4. Koordinatat në sistemin referues gjeodezik zyrtar – KRGJSH, të “qendrës historike” paraqiten në aneksin 1, që është pjesë përbërëse e këtij plani.

Neni 5

Zona mbrojtëse dhe kufijtë e saj

1. Zona mbrojtëse përreth “qendrës historike” mbron e plotëson vlerat e trashëgimisë kulturore, historike, urbanistike, arkitektonike dhe të peizazhit.

2. Ajo shtrihet përreth “qendrës historike” dhe krijon një kalim të butë drejt pjesës tjetër të fshatit. Në pjesën juglindore, ajo shtrihet duke përfshirë edhe një pjesë të rrugës hyrëse për në fshat, e cila, nisur edhe nga konfiguracioni i terrenit, shërben për të mbrojtur më mirë peizazhin arkitektonik e kulturor të qendrës historike të fshatit Bënjë.

3. Kufijtë e zonës mbrojtëse paraqiten në hartën e zonifikimit, e cila është pjesë përbërëse e këtij plani.

4. Koordinatat në sistemin referues gjeodezik zyrtar – KRGJSH, të zonës mbrojtëse paraqiten në aneksin 2, pjesë përbërëse e këtij plani.

Neni 6

Ndërhyrjet e lejuara në qendrën historike

1. Ndërhyrjet në “qendrën historike” kanë si qëllim ruajtjen e mbrojtjen e vlerave të trashëgimisë kulturore, historike, urbanistike, arkitektonike dhe të peizazhit të fshatit Bënjë.

2. Brenda kësaj zone lejohen këto ndërhyrje:

a) Ndërhyrje sistematike restauruese, konservuese dhe të mirëmbajtjes;

b) Ndërhyrje restauruese, që synojnë ruajtjen e hapësirave urbanistike-arkitekturore, të rrethit rrugor tradicional në kompozim dhe teknikë, duke përfshirë të gjitha kanalizimet e vjetra të zbuluara ose që do të zbulohen, si dhe duke ruajtur të pandryshuar konfiguracionin e truallit të hapësirave dhe të shesheve publike;

c) Rikonstruksione dhe rindërtime të ndërtesave ekzistuese mbi strukturat ekzistuese, sipas formulimit kompozicional dhe arkitektonik



original, duke u bazuar në materiale arkivore e fotografike;

ç) Rehabilitimi i hapësirave, të cilat ndikojnë në vlerat e unitetit kompozicional të ansamblit, duke u bazuar në format dhe në teknikat tradicionale;

d) vendosja e strukturave të përkohshme, fiksimi i flamujve, vendosja e materialeve informuese dhe reklamuese, sipas nenit 101, të ligjit nr. 27/2018, “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”.

Neni 7

Ndërhyrjet e lejuara në monumentet e kulturës

1. Ndërhyrjet në monumentet e kulturës dhe në zonën mbrojtëse të tyre, të cilat ndodhen në “qendrën historike” dhe zonën mbrojtëse, kanë për qëllim ruajtjen e mbrojtjen e vlerave për të cilën janë shpallur pasuri kulturore.

2. Brenda kësaj zone lejohen:

a) ndërhyrje sistematike restauruese, konservuese dhe të mirëmbajtjes;

b) rjetëzime, me kusht që projekti i rjetëzimit të mos dëmtojë vlerën e pasurisë kulturore, sipas ligjit nr. 27/2018, “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”;

c) vendosja e strukturave të përkohshme, fiksimi i flamujve, vendosja e materialeve informuese dhe reklamuese, sipas nenit 101, të ligjit nr. 27/2018, “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”.

Neni 8

Ndërhyrjet e lejuara në zonën mbrojtëse të “qendrës historike”

Ndërhyrjet e lejuara brenda zonës mbrojtëse janë:

a) restaurime, rikonstruksione dhe rindërtime të ndërtesave ekzistuese;

b) rikonstruksione dhe ndërtime të reja të rrejtit rrugor, të shesheve dhe të linjave të infrastrukturës mbi- dhe nëntokësore;

c) ndërtime të reja, shtesa dhe përshtatje në sheshe të lira, në harmoni me karakteristikat e “qendrës historike”.

Neni 9

Ndërhyrjet e ndaluara në tërësinë e “qendrës historike” dhe zonës mbrojtëse të saj

1. Në hapësirën e “qendrës historike” dhe zonës mbrojtëse të saj nuk lejohen ndërtimet e reja që prekin monumentet e kulturës dhe zonat mbrojtëse të tyre.

2. Në zonën mbrojtëse të “qendrës historike” nuk lejohen ndërtimet me karakter industrial, me përjashtim të punishteve të artizanatit.

Neni 10

Kriteret e projektimit për rikonstruksione, ndërhyrjet e lejuara në “qendrën historike”, monumentet e kulturës dhe zonës mbrojtëse të tyre

1. Projektet për konservimin, restaurimin e mirëmbajtjen në “qendrën historike” dhe monumentet e kulturës hartohen në varësi të vlerave historike-kulturore të objektit apo monumentit për të cilët janë shpallur pasuri kulturore, si dhe në kriteret për konservim e restaurim, bazuar në kartat ndërkombëtare për restaurim.

2. Projektet për rikonstruksionin/rindërtimin e objekteve ekzistuese brenda “qendrës historike” hartohen bazuar në studimet urbanistike dhe arkitektonike:

a) duke ruajtur karakteristikat tradicionale të banesave të zonës;

b) duke respektuar raportet urbanistike e vëllimore, trajtimin arkitekturor dhe elementet arkitektonike;

c) duke ruajtur sa më shumë trajtimin origjinal të pamjeve të jashtme, duke respektuar volumin ekzistues, ndërsa brendësia e tyre mund të ndryshojë duke respektuar elemente të veçanta me vlerë për trashëgiminë kulturore;

ç) duke ruajtur, sa të jetë e mundur, karakteristikat origjinale të dukshme, të jashtme dhe të brendshme, tipologjinë, trajtimin arkitektonik dhe teknikën tradicionale;

d) bazuar në dokumentacionin e qartë fotografik dhe grafik, nëse disponohet.

3. Projektet për rikonstruksionin/rindërtimin e objekteve ekzistuese brenda zonës mbrojtëse hartohen bazuar në planin e detajuar vendor të



Bashkisë Përmet apo të studimeve urbanistike e arkitektonike:

a) duke ruajtur karakteristikat tradicionale të banesave në këtë zonë;

b) duke ruajtur sa më shumë trajtimin origjinal të pamjeve të jashtme, duke respektuar volumin ekzistues, ndërsa brendësia e tyre mund të ndryshojë duke respektuar elemente të veçanta me vlerë për trashëgiminë kulturore.

4. Projektet për ndërtimet të reja, shtesat dhe përshtatjet në sheshe të lira brenda zonës mbrojtëse hartohen vetëm në ato terriore, në të cilat leja e ndërtimit nuk bie ndesh me ligjin nr. 27/2018, “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”, këtë plan, ligjin “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit” dhe rregulla të tjera në fuqi:

a) duke ruajtur karakteristikat tradicionale të banesave në zonën e mbrojtur të “qendrës historike”;

b) duke respektuar përpjesëtimet urbanistike e vëllimore të treguesve zhvillimorë, parashikuar në planin e përgjithshëm vendor të Bashkisë Përmet;

c) duke respektuar tipologjinë e ndërtimeve në atë zonë lidhur me kompozimin planimetrik dhe planvendosjen në sheshin e ndërtimit;

ç) duke ruajtur kufizimin që lartësia e ndërtimeve të reja apo rikonstruksioneve dhe përshtatjeve nuk duhet të kalojë lartësinë e 3 (tre) kateve;

d) duke ruajtur origjinalitetin e ndërtimit të çatave të ndërtimeve të reja, në rastet e mbulesave me çati, në harmoni me peizazhin kulturor të zonës mbrojtëse;

dh) duke përcaktuar materialin, madhësinë, ngjyrën e dyerve dhe të dritareve, si dhe ngjyrën e fasadës së banesës/objektit, në harmoni me peizazhin kulturor të zonës mbrojtëse.

5. Projektet për rikonstruksionin dhe ndërtimet e reja të rrjetit rrugor, të shesheve dhe linjave të infrastrukturës mbi- dhe nëntokësore hartohen:

a) bazuar në parashikimet e planit të përgjithshëm vendor të Bashkisë Përmet;

b) duke mos cenuar vlerat e objekteve ekzistuese;

c) duke mos krijuar kontrast me kompozimin urban dhe arkitektonik.

Neni 11

Studimi, projektimi dhe zbatimi i punimeve në “qendrën historike”, monumentet e kulturës të veçanta dhe zonës mbrojtëse të saj

1. Studimet për vlerësimin e ndërhyrjeve konservuese dhe restauruese në “qendrën historike” dhe zonën mbrojtëse të saj, duke përfshirë banesat, fasadat e tyre, muret rrethuese, kalldrëmet tradicionale dhe elemente të tjera urbanistike-arkitektonike dhe monumenteve të kulturës hartohen nga Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore (IKTK), Drejtorja Rajonale e Trashëgimisë Kulturore (DRTK) Gjirokastër ose/dhe nga persona fizikë apo juridikë të licencuar në fushën e restaurimit dhe miratohen në Këshillin Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale (KKTKM). Mbikëqyrja e punimeve dhe kolaudimi kryhen sipas legjislacionit në fuqi për trashëgiminë kulturore.

2. Projektet për konservimin, restaurimin dhe mirëmbajtjen në “qendrën historike” dhe monumentet e kulturës hartohen nga IKTK-ja, DRTK Gjirokastër ose/dhe nga persona fizikë apo juridikë të licencuar për projektim në fushën e restaurimit. Projektet shqyrtohen dhe miratohen në KKTKM. Zbatimi i punimeve kryhet nga DRTK Gjirokastër ose subjekte të licencuara për zbatim në fushën e restaurimit. Mbikëqyrja e punimeve dhe kolaudimi kryhen sipas legjislacionit në fuqi për trashëgiminë kulturore.

3. Projektet për rikonstruksionin/rindërtimin e objekteve ekzistuese, rehabilitimin e hapësirave në “qendrën historike” hartohen nga IKTK-ja, DRTK Gjirokastër ose nga subjekte të licencuara, sipas legjislacionit në fuqi për trashëgiminë kulturore. Projektet shqyrtohen dhe miratohen në KKTKM. Procedura e miratimit vijon sipas ligjit për planifikimin e territorit. Zbatimi i punimeve të rikonstruksionit kryhet nga subjekte të licencuara për zbatim në fushën e restaurimit. Mbikëqyrja e punimeve dhe kolaudimi kryhen sipas legjislacionit në fuqi për trashëgiminë kulturore.

4. Projektet për rikonstruksionin/rindërtimin e objekteve ekzistuese dhe ndërtimet të reja në zonën mbrojtëse hartohen nga IKTK-ja, DRTK Gjirokastër ose nga persona të licencuar për këtë kategori projektesh. Projektet shqyrtohen dhe miratohen në KKTKM. Procedura e miratimit vijon sipas ligjit për planifikimin dhe zhvillimin e



territorit. Zbatimi i punimeve të rikonstruksionit kryhet nga subjekte të licencuara në këtë kategori. Mbikëqyrja dhe kolaudimi kryhen nga subjekte të licencuara në këtë kategori dhe monitorohet nga DRTK Gjirokastër.

5. Projektet për rikonstruksionin e rrjetit rrugor dhe të shesheve në “qendrën historike” hartohen nga IKTK-ja, DRTK Gjirokastër ose/dhe nga persona fizikë apo juridikë të licencuar për projektim në fushën e restaurimit dhe projektet për realizimin e linjave të infrastrukturës mbi- dhe nëntokësore hartohen nga persona të licencuar sipas ligjit të planifikimit dhe zhvillimit të territorit. Projektet shqyrtohen dhe miratohen në KKTKM. Procedura e miratimit vijon sipas ligjit për planifikimin dhe zhvillimin e territorit. Zbatimi i punimeve kryhet nga DRTK Gjirokastër ose subjekte të licencuara për zbatim në fushën e restaurimit dhe sipas legjislacionit për planifikimin dhe zhvillimin e territorit. Mbikëqyrja dhe kolaudimi i punimeve kryhet sipas legjislacionit në fuqi për trashëgiminë kulturore dhe ligjit për planifikimin dhe zhvillimin e territorit.

6. Projektet për rikonstruksionin dhe ndërtimet e reja të rrjetit rrugor, shesheve dhe linjave të infrastrukturës mbi- dhe nëntokësore në zonën mbrojtëse hartohen nga persona të licencuar sipas legjislacionit në fuqi për planifikimin dhe zhvillimin e territorit. Projektet shqyrtohen dhe miratohen në KKTKM. Procedura e miratimit vijon sipas ligjit

për planifikimin dhe zhvillimin e territorit. Zbatimi i punimeve të rikonstruksionit, mbikëqyrja dhe kolaudimi kryhen sipas ligjit për planifikimin dhe zhvillimin e territorit. DRTK Gjirokastër monitoron procesin e zbatimit të punimeve.


7. Projektet për vendosjen e strukturave të përkohshme, fiksimit e flamujve, vendosjen e materialeve informuese dhe reklamuese në “qendrën historike” dhe monumentet e kulturës shqyrtohen nga IKTK-ja, DRTK Gjirokastër e miratohen me urdhrin e ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore. Në rastet kur projekti parashikon ndërhyrje në pasuritë kulturore, hartimi bëhet nga persona fizikë apo juridikë të licencuar për projektim në fushën e restaurimit. Projektet shqyrtohen e miratohen edhe në KKTKM. Procedura më pas vijon me urdhër ministri. Mbikëqyrja e punimeve kryhet nga DRTK Gjirokastër.

Neni 12

Dispozita të fundit

1. Shtesat dhe ndryshimet në këtë plan bëhen me propozim të ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore dhe miratohen nga Këshilli i Ministrave.

2. Këtij plani i bashkëngjitet zonifikimi i “qendrës historike”, i zonës mbrojtëse të saj dhe tabelat përkatëse të koordinatave gjeografike.





B1	535486.367548362	4457583.03359841
B2	535528.175119342	4457588.16559091
B3	535550.16999502	4457584.87624269
B4	535554.093767586	4457554.66651533
B5	535543.818630668	4457528.39974641
B6	535555.223716531	4457515.49853916
B7	535543.575565056	4457479.663316
B8	535454.085575434	4457461.96897035
B9	535441.079847362	4457463.45011784
B10	535417.713297664	4457507.14044224
B11	535402.347204123	4457507.9936727
B12	535394.965840999	4457519.68018051
B13	535366.378073927	4457517.69540401
B14	535364.274199013	4457512.75032409
B15	535338.500740886	4457515.40561268
B16	535324.983079768	4457535.28404017
B17	535323.442704623	4457551.42387034
B18	535338.482786524	4457569.69292164
B19	535349.728474076	4457590.72028379
B20	535348.735452419	4457600.89451799
B21	535357.43924735	4457609.57193778
B22	535367.862412418	4457604.37712706
B23	535383.434256362	4457610.00226764
B24	535394.262087123	4457619.30659553
B25	535403.257144589	4457616.26429151
B26	535415.936492838	4457633.90552194
B27	535427.041137122	4457634.57456446
B28	535435.991275851	4457641.0940753
B29	535478.419174918	4457614.76668688
B30	535487.472310296	4457599.38670815

Z1	535492.765726996	4457629.6398283
Z2	535570.223330923	4457592.37359668
Z3	535612.282689597	4457544.14517985
Z4	535654.145606501	4457487.58788381
Z5	535650.294064658	4457452.40624515
Z6	535650.95330223	4457412.92760836
Z7	535630.241534428	4457394.63114611
Z8	535576.840736536	4457391.91153236
Z9	535490.913549428	4457420.50122906
Z10	535426.031105573	4457447.03153053
Z11	535393.531451686	4457472.78888382
Z12	535359.155797134	4457495.45307198
Z13	535327.923469417	4457503.01803134
Z14	535304.393535451	4457531.28538162
Z15	535310.121423745	4457569.86857441
Z16	535304.279113885	4457606.238462
Z17	535315.233640678	4457638.98555385
Z18	535378.081638759	4457642.67298682
Z19	535418.923350383	4457652.11816442
Z20	535440.667168177	4457651.91183251
Z21	535460.469601887	4457662.49222973
Z22	535494.04584529	4457658.94871675
Z23	535501.918760811	4457643.2547505



VENDIM

Nr. 833, datë 24.12.2021

**PËR MËNYRËN E NGRITJES,
ADMINISTRIMIT, MIRËMBAJTJES SË
BAZËS SË TË DHËNAVE PËR RININË,
SI DHE MËNYRËN E NDËRVEPRIMIT
TË SAJ ME BAZAT E TJERA TË TË
DHËNAVE SHTETËRORE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 4, të ligjit nr. 10325, datë 23.9.2010, “Për bazat e të dhënave shtetërore”, dhe të pikës 4, të nenit 18, të ligjit nr. 75/2019, “Për rininë”, me propozimin e ministrit të Shtetit për Rininë dhe Fëmijët, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Krijimin dhe funksionimin e bazës së të dhënave për rininë, si regjistër elektronik për rininë (në vijim, RER).

2. Agjencia Kombëtare për Rininë (në vijim “AKR”), si institucioni përgjegjës për rininë, administron RER-in dhe është dhënësi i informacionit, në kuptim të legjislacionit për bazat e të dhënave shtetërore.

3. Të dhënat që përmban RER-i ndahen në të dhëna parësore dhe në të dhëna dytësore, si më poshtë vijon:

a) Të dhëna parësore do të konsiderohen:

i. numri i aplikimit nga Organizata Kombëtare Përfaqësuese Rinore, organizata rinore dhe për të rinjtë, në vend apo në diasporë, për regjistrim në RER;

ii. numri i regjistrimit në RER të Organizatës Kombëtare Përfaqësuese Rinore, organizatave rinore dhe për të rinjtë, në vend apo në diasporë;

iii. të dhëna për politikën rinore kombëtare, të miratuara në fushën e planifikimit strategjik rinor (në rast se ka);

iv. të dhëna për politikën rinore vendore (në rast se ka);

v. të dhëna për politikën rinore evropiane (në rast se ka).

b) Të dhëna dytësore konsiderohen ato të dhëna që përfshijnë:

i. të dhënat e regjistrimit gjyqësor në lidhje me organizatat jofitimprurëse, për numrin dhe datën e regjistrimit të subjektit, llojin (formën e

organizimit) e organizatës jofitimprurëse, emrin e subjektit, fushën e veprimtarisë dhe misionin e tij;

ii. të dhënat e regjistrimit tregtar për datën e regjistrimit të subjektit, emrin e subjektit/shoqërisë tregtare, numrin unik të identifikimit të subjektit, llojin e shoqërisë tregtare (formën e organizimit të saj), fushën e veprimtarisë dhe misionin e tij/saj, statusin e tij;

iii. të dhënat e regjistrave që lidhen me studime, analiza, vlerësime, vëzhgime dhe vlerësime të zbatimit të politikave rinore (në rast se ka);

iv. të dhënat e regjistrave që kanë të bëjnë me financimin e projekteve dhe veprimtarive rinore (në rast se ka).

Të dhënat dytësore të mësipërme trajtohen si informacion konfidencial, në përputhje me përcaktimet e legjislacionit të posaçëm, për aq sa trajtohen si të tilla prej tij. Përdorimi i tyre është i lejuar vetëm për punonjësit e AKR-së, që përdorin bazën e të dhënave.

4. Mbrojtja dhe përpunimi i të dhënave të grumbulluara bazohet në:

a) parimin e ndershmërisë, të drejtësisë dhe të ligjshmërisë;

b) grumbullimin për qëllime specifike, të përcaktuara qartë dhe në përputhje me këto qëllime;

c) saktësinë nga ana faktike dhe, kur është e nevojshme, përditësimin e kryerjen e çdo veprimi për të siguruar që të dhënat e pasakta të ndryshohen ose të rregullohen;

ç) garantimin e masave teknike dhe organizative të përshtatshme për të mbrojtur të dhënat personale nga shkatërrime të paligjshme, humbje aksidentale, për të mbrojtur aksesin ose përhapjen nga persona të paautorizuar, veçanërisht kur përpunimi i të dhënave bëhet në rrjet, si dhe nga çdo formë tjetër e paligjshme përpunimi;

d) kryerjen e çdo veprimi në sistem lidhur me aksesin, ndryshimin, korrigjimin, përhapjen e të dhënave etj., duke lënë gjurmë me qëllim garantimin e sigurisë dhe konfidencialitetit të të dhënave;

dh) mbajtjen e të dhënave që lejojnë identifikimin e subjekteve (organizatave rinore dhe për të rinjtë) për një kohë të caktuar, por jo më tepër sesa është e nevojshme për arritjen e qëllimit për të cilin janë regjistruar.

5. Të dhënat e mbledhura nga RER-i mund të përdoren për kërkime shkencore e statistikore,



analiza, vlerësime apo projekte të ndryshme, sipas legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.

6. Të dhënat e RER-it përditësohen periodikisht nga AKR-ja, sa herë është e nevojshme apo ka ndryshime të këtyre të dhënave.

7. Niveli i aksesimit në sistemin për personat e interesuar të bazës së të dhënave RER është, si më poshtë vijon:

a) Të rinjtë, organizatat rinore dhe organizatat për të rinjtë dhe Organizata Kombëtare Përfaqësuese për Rininë kanë nivel aksesit si lexues të RER-it e dërgues të kërkesave për informacion publik, nëpërmjet portalit “Për rininë”;

b) AKR-ja ka akses si administrator dhe përdorues i RER-it. Niveli i aksesimit, funksionet e të drejtat për secilën kategori përdoruesi të sistemit janë në përputhje me pozicionin e punës së punonjësit të AKR-së.

8. Baza e të dhënave të RER-it ndërvepron nëpërmjet shkëmbimit elektronik të të dhënave me:

a) bazën e të dhënave të regjistrimit gjyqësor për regjistrimin e organizatave jofitimprurëse (OJF-ve);

b) bazën e të dhënave të regjistrimit tregtar;

c) bazën e të dhënave të informacionit të planifikimit të integruar – SIPI.

9. Ngarkohen ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët, Agjencia Kombëtare për Rininë, Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit, Organizata Kombëtare Përfaqësuese Rinore, organizatat rinore dhe organizatat për të rinjtë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR

Edi Rama

VENDIM

Nr. 69, datë 22.12.2021

PËR DISA NDRYSHIME NË RREGULLOREN “PËR KREDINË KONSUMATORE DHE KREDINË HIPOTEKARE”

Në bazë dhe për zbatim të nenit 12, shkronja “a”, dhe të nenit 43, shkronja “c”, të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, “Për Bankën e Shqipërisë”, të ndryshuar; të neneve 44 dhe 45 të ligjit nr. 9902, datë 17.4.2008, “Për mbrojtjen e konsumatorëve”, të ndryshuar; si dhe nenit

124 të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006, “Për Bankat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar; Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, me propozimin e Departamentit të Mbikëqyrjes,

VENDOSI:

1. Në rregulloren “Për kredinë konsumatore dhe kredinë hipotekare”, miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 48, datë 1.7.2015, e ndryshuar, të bëhen ndryshimet e mëposhtme:

a) në nenin 5, pika 2, pas shkronjës “k”, shtohen shkronjat “l”, “m”, “n” dhe “o” me përmbajtjen e mëposhtme:

“l) *“tejkallim limiti (overrunning)” është kredia kufi (overdraft) e pranuar/njobur në beshtje nga banka, nëpërmjet të cilës banka i vë në dispozicion konsumatorit fonde të cilat tejkalojnë gjendjen (balancën) aktuale të llogarisë rjedhëse të konsumatorit ose të kredisë kufi (overdraftit), për të cilën është rënë dakord;*

m) *“vlera totale e kredisë” është shuma totale e kredisë e disponueshme ose kufiri i kredisë në rastin e kredisë kufi (overdraftit) dhe/ose kartës së kreditit, sipas kontratës së kredisë;*

n) *“shuma totale që paguan konsumatori” është shuma e vlerës totale të kredisë dhe kostos totale të kredisë së konsumatorit;*

o) *shërbimet ndihmëse (ancillary)” janë shërbimet që i ofrohen konsumatorit në lidhje me kontratën e kredisë.”;*

b) në nenin 6 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

i. në pikën 2, shkronja “b” ndryshon me përmbajtjen e mëposhtme:

“b. *vlerën totale të kredisë;*”;

ii. në pikën 2, pas shkronjës “d”, shtohet shkronja “d/1” me përmbajtjen e mëposhtme:

“d/1. *në rastin e një kredie në formën e një pagese të shtyrë, për një mall ose shërbim të veçantë, emërtimin e mallit ose shërbimit dhe çmimin në para (cash);*”;

iii. në pikën 2, pas shkronjës “u”, shtohet shkronja “v” me përmbajtjen e mëposhtme:

“v. *të drejtën e konsumatorit për t’u pajisur, me kërkesën e tij dhe pa pagesë, me një kopje të projektkontratës së kredisë. Kjo e drejtë nuk do të ushtrohet nëse banka, në kohën e kërkesës, nuk është e gatshme të vazhdojë me nënshkrimin e kontratës së kredisë me konsumatorin.”;*

iv. pas pikës 2, shtohet pika 2/1 me përmbajtjen e mëposhtme:

“2/1. *Çdo informacion shtesë që banka mund t’i japë konsumatorit, do të paraqitet në një dokument të veçantë, i*



cili mund t'i bashkëngjitet informacionit të standardizuar parakontraktor, pjesë e aneksit 1 të kësaj rregulloreje”;

c) në nenin 7 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

i. në pikën 2, pas shkronjës “e”, shtohet shkronja “e/1” me përmbajtjen e mëposhtme:

“e/1. në rastin e një kredie në formën e një pagese të shtyrë, për një mall ose shërbim të veçantë, emërtimin e mallit ose shërbimit dhe çmimin në para (cash);”;

ii. në pikën 2, pas shkronjës “t”, shtohet shkronja “u” me përmbajtjen e mëposhtme:

“u) në rastin kur përfshihet plani i shlyerjes së kredisë në një kontratë kredie me kohëzgjatje fikse/ me afat, të drejtën e konsumatorit për të marrë, me kërkesë të tij dhe pa pagesë, në çdo kohë gjatë gjithë kohëzgjatjes së kontratës së kredisë, gjendjen e llogarisë, në formën e një plani shlyerjeje (informacion për shumën që ka shlyer dhe detyrimin e mbetur).”;

d) në nenin 9, pas pikës 5 shtohet pika 6 me përmbajtjen e mëposhtme:

“6. Në rastet kur banka ose një palë e tretë ofron një shërbim ndihmës në lidhje me kontratën e kredisë, në bazë të një kontrate midis palës së tretë dhe bankës, konsumatori nuk do të ketë më detyrime nga kontrata e shërbimit ndihmës, nëse ai (konsumatori) tërhiqet nga kontrata e kredisë, në përputhje me këtë nen.”;

e) pas nenit 10, shtohet neni 10/1 me përmbajtjen e mëposhtme:

“Neni 10/1

Tejkalimi i limitit (overrunning)

1. Në rastin e një kontrate për hapjen e një llogarie rrjedhëse, ku ekziston mundësia që konsumatori të pranojë t'i ofrohet një tejkalim limiti, kontrata do të përmbajë edhe informacionin shtesë të parashikuar në shkronjën “f” të pikës 2 të nenit 6 të kësaj rregulloreje. Banka, në çdo rast, kur ka tejkalim të limitit, vendos në dispozicion të konsumatorit këtë informacion, me shkruesë ose nëpërmjet një mjeti tjetër të qëndrueshëm komunikimi, në mënyrë të rregullt.

2. Në rast të një tejkalimi të rëndësishëm/të konsiderueshëm të limitit, për një periudhë prej më shumë se 1 (një) muaji, banka njofton konsumatorin pa vonesë, me shkruesë ose nëpërmjet një mjeti tjetër të qëndrueshëm komunikimi, për:

a) tejkalimin e limitit;

b) shumën e tejkalimit;

c) normën e interesit;

d) çdo penalitet, komision apo interes të aplikuueshëm.”;

f) në aneksin 1 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

i. në tabelën 2, pas rreshtit të 8-të, “Shuma totale që konsumatori do të ketë për të paguar”, shtohet rreshti i 9-të me përmbajtjen e mëposhtme:

<p><i>Nëse është e aplikueshme</i> Kredia jepet në formën e një pagese të shtyrë për një mall ose shërbim, ose lidhet me furnizimin e mallrave të veçanta ose ofrimin e një shërbimi Emërtimi i mallit/shërbimit Çmimi në para (cash)</p>	
---	--

ii. në tabelën 3 “Kostoja e kredisë”, rreshti i 3-të ndryshon si më poshtë:

<p><i>A është e mundur të përfitohet kredia sipas kushteve të punës në të cilat tregtohet, duke përjashtuar:</i> - kontratat e sigurimit për kredinë; - një kontratë tjetër të shërbimeve ndihmëse. Nëse kostot e këtyre shërbimeve nuk njihen nga banka, ato nuk do të përfshihen në NEI.</p>	<p><i>Po/jo [nëse po, specifikoni llojin e sigurimit]</i> <i>Po/jo [nëse po, specifikoni llojin e shërbimit ndihmës]</i></p>
--	--

iii. në tabelën 4, rreshti i parë “E drejta për t’u tërhequr”, në kolonën e dytë shtohet togfjalëshi “Po/Jo”;

iv. në tabelën 4, pas rreshtit të 6-të, “Informimi në rast refuzimi të kredisë”, shtohet rreshti i 7-të me përmbajtjen e mëposhtme:

<p><i>E drejta e pajisjes me kopjen e projektkontratës së kredisë</i> Konsumatori ka të drejtën për t’u pajisur, me kërkesën e tij dhe pa pagesë, me një kopje të projektkontratës së kredisë. Kjo e drejtë nuk do të zbatohet nëse banka, në kohën e kërkesës, nuk është e gatshme të vazhdojë me nënshkrimin e kontratës së kredisë me konsumatorin.</p>	
--	--



2. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes, për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

3. Ngarkohet Kabineti i Guvernatorit dhe Departamenti i Kërkimeve me publikimin e këtij vendimi, përkatësisht në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë dhe në Buletin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi më 31 mars 2022.

KRYETAR
Gent Sejko

VENDIM
Nr. 70, datë 22.12.2021

**PËR DHËNIEN E MIRATIMIT
PARAPRAK PËR ZOTËRIMIN E
PJESËMARRJES INFLUENCUESE (TË
KONTROLLIT TË TËRTHORTË) NË
KAPITALIN AKSIONAR TË “BANKËS
AMERIKANE TË INVESTIMEVE” SHA**

Në bazë dhe për zbatim të shkronjës “e”, të nenit 43, të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, “Për Bankën e Shqipërisë”, të ndryshuar; të shkronjës “h” të pikës 1, të nenit 24, dhe nenit 25, të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006, “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar; si dhe të rregullores “Për licencimin dhe ushtrimin e veprimtarisë së bankave dhe të degëve të bankave të huaja në Republikën e Shqipërisë”, miratuar me vendimin nr. 14, datë 11.3.2009, të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, e ndryshuar; me propozim të Departamentit të Mbikëqyrjes, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë

VENDOSI:

1. Të japë miratimin paraprak për zotërimin e pjesëmarrjes influencuese (të kontrollit të tërthortë) në masën 80% të shoqërisë MOSCOPOLE INC, SHBA, në kapitalin aksionar të “Bankës Amerikane të Investimeve” sh.a.

2. Ngarkohet Banka Amerikane e Investimeve të njoftojë Bankën e Shqipërisë për përfundimin e transaksioneve të përmendura në pikën 1 të këtij vendimi.

3. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

4. Ngarkohen Kabineti i Guvernatorit dhe Departamenti i Kërkimeve për publikimin e këtij vendimi, përkatësisht në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë dhe në Buletin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Gent Sejko

UDHËZIM
Nr. 3, datë 22.12.2021

**PËR RAPORTIMIN E VEPRIMEVE TË
KËMBIMEVE VALUTORE**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 43, shkronja “e”, dhe nenit 65, të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, “Për Bankën e Shqipërisë”, të ndryshuar; me propozim të Departamentit të Operacioneve Monetare, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë

UDHËZON:

Neni 1
Qëllimi dhe subjektet

1. Qëllimi i këtij udhëzimi është përcaktimi i mënyrave, i formave të raportimit, si dhe i formularëve që duhet të dorëzojnë subjektet e këtij udhëzimi për veprimet e kryera të këmbimeve valutore.

2. Subjekte raportuese të këtij udhëzimi janë bankat, zyrat e këmbimit valutator dhe subjektet financiare jobanka të licencuara nga Banka e Shqipërisë për ushtrimin e aktivitetit të këmbimit valutator.

Neni 2
Përkufizime

Për qëllime të këtij udhëzimi, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

a) **“veprime të këmbimeve valutore”** janë veprimet *spot, forward dhe swap*;

b) **“spot”** janë veprime të këmbimeve valutore, sipas përcaktimit të rregullores së Bankës së Shqipërisë, “Mbi procedurat e ndërhyrjes së Bankës



së Shqipërisë në tregun e brendshëm të këmbimeve valutore”;

c) **“forward”** janë veprime të këmbimeve valutore, sipas përcaktimit të rregullores së Bankës së Shqipërisë, “Mbi procedurat e ndërhyrjes së Bankës së Shqipërisë në tregun e brendshëm të këmbimeve valutore”;

d) **“swap”** janë veprime të këmbimeve valutore, sipas përcaktimit të rregullores së Bankës së Shqipërisë, “Mbi procedurat e ndërhyrjes së Bankës së Shqipërisë në tregun e brendshëm të këmbimeve valutore”.

Neni 3

Raportimet e veprimeve të këmbimeve valutore dhe raportimet e pozicioneve valutore

1. Bankat duhet të raportojnë me frekuencë ditore të gjitha veprimet e këmbimeve valutore të çdo monedhe të huaj kundrejt Lekut, përfshirë veprimet me arin, sipas ndarjes *spot*, *forward* apo *swap*, brenda orës 17:00 të ditës në të cilën është lidhur marrëveshja, duke specifikuar monedhën e huaj, shumën dhe kursin e këmbimit. Veprimet e kryera pas kësaj ore dhe pozicioni valutor në çdo monedhë të huaj duhet të raportohen deri në orën 09:00 të ditës pasardhëse të punës.

2. Raportimi i veprimeve *forward* dhe *swap* duhet të bëhet në ditën e lidhjes së marrëveshjes dhe duhet të përfshijë kursin *spot*, pikët *forward* ose *swap* dhe datën e maturimit. Efekti i veprimeve *forward* dhe *swap* duhet të reflektohet në pozicionin valutor të bankave në ditën e lidhjes së marrëveshjes.

3. Zyrat e këmbimit valutor dhe subjektet financiare jobanka duhet të raportojnë me frekuencë ditore të gjitha veprimet e këmbimeve valutore të çdo monedhe të huaj kundrejt lekut, sipas ndarjes *spot*, *forward* apo *swap*, brenda orës 12:00 të ditës pasardhëse të punës në të cilën është lidhur marrëveshja. Raportimi duhet të përmbajë monedhën e huaj, shumën dhe kursin e këmbimit.

4. Zyrat e këmbimit valutor dhe subjektet financiare jobanka duhet të raportojnë me frekuencë javore pozicionin valutor në çdo monedhë të huaj, në ditën pasardhëse të punës për javën e mbyllur ditën e premte. Në këtë raportim duhet të përfshihen, të identifikuar më vete, edhe veprimet që mund të jenë kryer gjatë ditës së shtunë dhe të diel.

Neni 4

Mënyrat e raportimit të veprimeve të këmbimeve valutore

1. Veprimet që kryejnë subjektet e këtij udhëzimi midis njëri-tjetrit duhet të specifikohen individualisht në datën e lidhjes së marrëveshjes. Raportimi i këtyre veprimeve duhet të përmbajë emrin e subjektit me të cilin është kryer veprimi, llojin e veprimit (*spot*, *forward* apo *swap*), monedhën e huaj, shumën dhe kursin e këmbimit.

2. Çdo veprim i kryer nga një nga subjektet e këtij udhëzimi me një klient që është person juridik ose person fizik tregtar dhe që është në vlerën minimalisht 50.000 euro ose në ekuivalentin e kësaj shume, duhet të raportohet duke specifikuar emrin e klientit, monedhën e huaj, shumën dhe kursin e këmbimit.

3. Nëse shuma totale e veprimeve të kryera brenda një dite, nga një nga subjektet e këtij udhëzimi me një klient që është person juridik ose person fizik tregtar, është në vlerën minimalisht 50.000 euro ose në ekuivalentin e kësaj shume, atëherë këto veprime duhet të raportohen individualisht, duke specifikuar emrin e klientit dhe kurset përkatëse.

4. Në rastin e veprimeve të këmbimeve valutore të kryera nga klientë që janë persona fizikë, subjektet e këtij udhëzimi duhet të raportojnë:

a) çdo veprim të kryer nga një klient i vetëm në vlerën minimalisht 50.000 euro ose në ekuivalentin e kësaj shume, por pa specifikuar emrin;

b) shumën totale të veprimeve të kryera brenda një dite me një klient, nëse është minimalisht 50,000 euro ose në ekuivalentin e kësaj shume, por pa specifikuar emrin.

5. Të gjitha veprimet e këmbimeve valutore të tjera që janë nën vlerën 50.000 euro ose nën ekuivalentin e kësaj shume, duhet të raportohen të agreguara si një shumë e vetme totale për secilën monedhë të huaj, së bashku me kursin mesatar të ponderuar të këtyre veprimeve ndaj lekut.

Neni 5

Formularët e raportimit

1. Raportimi ditor i veprimeve të këmbimeve valutore *spot* valutë – lekë bëhet, sipas formularit 1, bashkëlidhur këtij udhëzimi.



2. Raportimi i pozicionit valutor ditor/javor bëhet sipas formularit 2, bashkëlidhur këtij udhëzimi.

3. Raportimi ditor i veprimeve të këmbimeve valutore *forward/swap* valutë – lekë bëhet sipas formularit 3, bashkëlidhur këtij udhëzimi.

4. Raportimet përcillen të paktën në njërën nga mënyrat vijuese: nëpërmjet *email-it*, korrespondencës zyrtare të protokolluar, sistemit ERRS ose platformës *Refinitiv FX Trading*.

Neni 6

Dokumente shoqëruese të raportimit

1. Banka e Shqipërisë, në rast se e vlerëson të arsyeshme, mund t'ju kërkojë subjekteve të këtij udhëzimi të dorëzojnë dokumente shoqëruese, krahas raportimit sipas formularëve përkatës.

2. Departamenti i Operacioneve Monetare në Bankën e Shqipërisë ka të drejtë të kontaktojë me subjektet e këtij udhëzimi për t'ju kërkuar informacion shtesë për veprimet e kryera prej tyre, si p.sh. natyrën e veprimit, orën e lidhjes së marrëveshjes etj.

Neni 7

Të fundit

1. Me zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohen Departamenti i Operacioneve Monetare, Departamenti i Statistikave Financiare, Departamenti i Mbikëqyrjes në Bankën e Shqipërisë, si dhe bankat, zyrat e këmbimit valutor dhe subjektet financiare jobanka të licencuar nga Banka e Shqipërisë për ushtrimin e aktivitetit të këmbimit valutor.

2. Me hyrjen në fuqi të këtij udhëzimi, shfuqizohet vendimi i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr. 68, datë 27.11.2012, për miratimin e udhëzimit, “Për raportimin e veprimeve të këmbimeve valutore”.

Neni 8

Hyrja në fuqi

Ky udhëzim hyn në fuqi më datë 1 janar 2022 dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I KËSHILLIT MBIKËQYRËS
Gent Sejko

Formulari 1

Raportimi ditor i veprimeve valutore spot valutë – lekë

1. Klienti	Lloji i transaksionit	Emri nëse është veprim > 50.000 EUR (përfshijë individët)	Monedha	Shuma e blerë	Kursi	Monedha	Shuma e shitur	Kursi
Individ								
.....								
Biznes								
.....								
Kompani/institucion shtetëror								
.....								
Banka e Shqipërisë								
.....								
Bankë								
.....								
Zyrë këmbimi valutor								
.....								
Subjekt financiar jobankë								
.....								
2. Veprime të brendshme								
Provizione								
.....								
<i>Write off</i>								
.....								
Konvertime kredie								
.....								
Konvertim kapitali								
.....								
Veprime finance								



.....								
3. Të tjera								
.....								

Formulari 2
Raportimi ditor/javor i pozicionit valutor

Monedha	Shuma në blerje	Shuma në shitje

Formulari 3

Raportimi ditor i veprimeve valutore forward/swap valutë - lekë

Klienti	Lloji i transaksionit	Emri nëse është veprim >= 50.000 EUR (përfshijë individët)	Monedha	Shuma e blerë	Kursi spot	Pikët forward/swap	Data e maturimit	Monedha	Shuma e shitur	Kursi spot	Pikët forward/swap
Individ											
.....											
Biznes											
.....											
Kompani/Institucion shtetëror											
.....											
Banka e Shqipërisë											
.....											
Bankë											
.....											
Zyrë këmbimi valutor											
.....											
Subjekt financiar jobankë											
.....											
Të tjera											

*Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë
të një procedure automatike nga një sistem elektronik
(Qendra e Botimeve Zyrtare)*

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2021

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 352 lekë